



Implemented by:
giz Deutsche Gesellschaft
für Internationale
Zusammenarbeit (GIZ) GmbH



Agjenda 2030 në komunën time

Doracak për shërbyesit/praktikuesit për lokalizimin e
Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ-të)



Ky doracak është produkt i Projektit Rajonal të GIZ për të Drejtat Sociale për Grupet e Cenuara (SoRi) autorizuar nga Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (BMZ).

Opinionet e deklaruara në këtë publikim përfaqësojnë opinionin e autorit (ve) dhe nuk përfaqësojnë domosdo qëndrimin e Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH dhe të Projektit Rajonal për të Drejtat Sociale të Grupeve të Cenuara.

Agjenda 2030 në komunën time



Doracak për shërbyesit/praktikuesit për
lokalizimin e Objektivave të Zhvillimit të
Qëndrueshëm (OZHQ-të)

Thomas Prorok
Ankica Todorović
Dalilah Pichler
Mladen Ivanović
Lena Rücker
Mile Pejčić

Shkurt 2019

Përmbajtja

OZHQ-të: Krejt çfarë duhet të dini	6
1 Çfarë janë OZHQ-të?	7
2 Kush është përgjegjës për implementimin e OZHQ-ve?	9
3 Vështrim i përgjithshëm i OZHQ-ve – 17 objektivat	10
Ndikimi i OZHQ-ve në komuna	14
1 Si ndikojnë OZHQ-të tek komunitat?	15
2 Detyrat dhe aktivitetet komunale të ndërlidhura me OZHQ-të	16
3 #LOKALIZIMI I OZHQ-ve – hapat themelorë për implementimin e Agjendës 2030	17
Ndërgjegjësimi për OZHQ-të	18
1 Roli i qeverive lokale	19
2 Hapat e ndërgjegjësimit	20
3 Mjetet e ndërgjegjësimit	22
3.1 Hapi 1: Informimi i stafit komunal dhe zyrtarëve të përzgjedhur për OZHQ-të	23
3.2 Hapi 2: Inkorporimi i OZHQ-ve në mjetet komunale të komunikimit dhe informimit i publiku	23
3.3 Hapi 3: Nisja e një dialogu me bazë të gjerë	26
3.4 Hapi 4: Themelimi i grupeve partnere	27
4 Shembuj nga Ballkani Perëndimor	32
4.1 Bijelinë (Bosnjë dhe Hercegovinë)	32
4.2 Bijelinë (Bosnjë dhe Hercegovinë)	34
4.3 Elbasan (Shqipëri)	36
4.4 Zemun (Serbi)	38
4.5 Prizren (Kosovë)	40

5	Shembuj ndërkombëtarë	42
5.1	Gent (Belgjikë)	42
5.2	Shtutgart (Gjermani)	44
5.3	Vienë (Austri)	46
5.4	Solingen (Gjermani)	48
Krijimi i agjendës lokale të OZHQ-ve		50
1	Integrimi i OZHQ-ve në strategjitë vendore	51
2	Përcaktimi i veprimeve të harmonizuara me OZHQ-të	53
3	Mjetet e punëtorive për grupet partnere	58
4	Shembuj nga Ballkani Perëndimor	66
4.1	Bijelinë (Bosnjë dhe Hercegovinë)	66
4.2	Elbasan, Librazhd dhe Kukës (Shqipëri)	68
5	Shembuj ndërkombëtarë	70
5.1	Vienë (Austri)	70
5.2	Hanover (Gjermani)	72
5.3	Ludvigsburg (Gjermani)	74
5.5	Portali OZHQ (Gjermani)	76
5.5	Sharnshtajn (Austri)	78
Roli i SHQL-ve dhe NALAS në mobilizimin e komunave për t'i arritur OZHQ-të		80
Informata të mëtejshme		84
1	Vegëza të ngjashme	85
2	Shtojca	86

Parathënie

Në vitin 2015, shtetet anëtare të OKB-së miratuan Agjendën 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe Objektivat e saj të Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe parimet e implementimit, të cilat përfaqësojnë vizionin për botën që duhet të përpiqemi ta bëjmë deri më 2030. Këto 17 objektiva me 169 synime mbulojnë një mori politikash sektoriale. Qeveritë vendore dhe rajonale kanë luajtur rol të rëndësishëm në ndikimin e përkufizimit të OZHQ-ve, duke bërë fushatë të suksesshme për një objektiv të vetëm për Qytete dhe Vendbanime të Qëndrueshme (OZHQ 11) dhe për njohje ndërkombëtare të rolit kyç të qeverisë vendore dhe rajonale në zhvillimin e qëndrueshëm.

Pasi që Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Agjendës 2030 duhet të arrihen në nivele globale, kombëtare dhe nënkombëtare, sukcesi i kësaj agjende ambicioze varet nga përfshirja aktive e çdo niveli të qeverisë dhe një vargu të gjatë akterësh. Prandaj qasjet me

shumë nivele dhe partneritetet me shumë akterë do të jenë faktorët kyç për ta bërë të arritshëm vizionin tonë të përbashkët për botën deri më 2030. Agjenda globale e zhvillimit nuk mund të kufizohet vetëm me kompetencën e qeverisë qendrore. Korniza e Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm me përkufizimin e saj univerzal të objektivave dhe synimeve duhet të përkthehet në situata konkrete dhe nevoja specifike për të krijuar përfitime reale për persona konkretë dhe për kushtet e tyre të jetesës.

Ky proces i marrjes parasysh të konteksteve nënkombëtare në arritjen e Agjendës 2030 është ajo që ne e kuptojmë përmes „Lokalizimit të OZHQ-ve“. Lokalizimi ka të bëjë me mënyrën se si OZHQ-të mund të ofrojnë një kornizë për politikën e zhvillimit lokal si dhe me mënyrën se si qeveritë lokale dhe rajonale mund ta përkrahin arritjen e OZHQ-ve përmes veprimtari nga lart poshtë. Ne në Projektin Rajonal „Të Drejtat Sociale për Grupet e Cenuara“ jemi të përkushtuar të punojmë

me komunat tona partnere për t'i përkrahur ato në mënyrë që kushtet e jetesës së shumicës së personave të cenuar të mund të përmirësohen. Ne jemi të bindur se komunat tona partnere janë niveli administrativ më i afërt me komunitetet lokale dhe mund të bëjnë një dallim kuptimplotë në jetërat e tyre, me kohë dhe në mënyrë fleksibile duke reaguar ndaj nevojave të reja dhe që po ndryshojnë shpejt.

Në këtë aspekt, kapacitetet e strukturave komunale për ta implementuar Agjendën 2030 dhe për ta monitoruar arritjen e OZHQ-ve në nivel vendor dhe përfshirjen e akterëve publik, privat dhe ata të shoqërisë civile janë thelbësore. Ky Doracak është hartuar për t'i shërbyer mu këtij qëllimi. Për t'iu ndihmuar shërbyesve/ praktikuesve në nivelin komunal në përmirësimin e njohurive të tyre dhe në përforcimin e kuptimit të rëndësisë së agjendës 2030 dhe OZHQ-ve në nivel lokal, në ngritjen e kapaciteteve të tyre për t'u bërë

promovues të OZHQ-ve dhe për të qenë në gjendje t'i sensibilizojnë akterët e tjerë.

Ne besojmë thellësisht dhe sinqerisht se ju do të bashkoheni në këtë përpjekje dhe se ky Doracak do të jetë i dobishëm dhe praktik në punën tuaj të përditshme.

Me respekt,



Michael Samec



1

**OZHQ-të:
Krejt çfarë
duhet të dini**

1 Çfarë janë OZHQ-të?

”

Ciljevi održivog
razvoja su
univerzalan
poziv na
delovanje da
bi se okončalo
siromaštvo,
zašttila planeta
i obezbedio
život svih
ljudi u miru i
prosperitetu.

Në shtator të vitit 2015, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara miratoi Agjendën 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm. Të gjitha Shtetet Anëtare të OKB-së u pajtuan për 17 **Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ-të)** për të arritur paqe dhe prosperitet për të gjithë njerëzit dhe planetin deri më 2030. OZHQ-të janë një set univerzal i objektivave, synimeve dhe treguesve të cilat shtetet anëtare të OZHQ-të janë zotuar t'i përdorin për t'i strukturuar politikat vendore dhe ato ndërkombëtare për zhvillim në 15 vitet e ardhshme. Ato ngriten mbi progresin e Objektivave të Mijëvjeçarit për Zhvillim (OMZH), për të cilat qeveritë u dakorduan në vitin 2001 dhe përfunduan në vitin 2015. Përderisa OMZH-të janë përqendruar në reduktimin e varfërisë ekstreme në të gjitha format, OZHQ-të ndjekin një agjendë më të gjerë që përfshin aspektet sociale, mjedisore dhe ekonomike të zhvillimit të

qëndrueshëm, i cili vlen për të gjitha shtetet në mbarë botën.

OZHQ-të adresojnë çështje vendimtare me të cilat përballet bota sot, duke përfshirë çrrënjosjen e varfërisë ekstreme, luftimin e pabarazisë globale dhe ndryshimeve klimatike, promovimin e urbanizimit të qëndrueshëm dhe zhvillimin industrial, mbrojtjen e ekosistemeve natyrore dhe promovimin e rritjes së komuniteteve paqësore e gjithëpërfshirëse dhe institucioneve qeverisëse.



SUSTAINABLE DEVELOPMENT GOALS



Burimi: Kombet e Bashkuara

Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm bashkojnë një numër të marrëveshjeve ndërkombëtare (për ndryshime klimatike, reduktim të varfërisë, etj.). Ato funksionojnë në frymën e partneritetit dhe pragmatizmit në të gjitha nivelet e qeverisë dhe shoqërisë për t'i marrë vendimet e duhura për përmirësimin e jetës për generatat aktuale dhe të ardhshme në mënyrë të qëndrueshme. OZHQ-të ofrojnë udhëzime dhe synime për të gjitha vendet, të cilat mund t'i

miratojnë ato në përputhje me prioritetet e tyre dhe sfidat mjedisore. Agjenda 2030 përbëhet nga tri dimensione të zhvillimit të qëndrueshëm – ekonomik, social dhe mjedisor – adresohen përmes 17 Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe 169 synimeve, të cilat maten përmes 231 treguesve.

Pse na nevojiten OZHQ-të?

Varfëria dhe mungesa e qasjes në shërbimet themelore të kujdesit shëndetësor, mundësitë e pamjaftueshme edukative, pabarazitë sociale dhe gjinore, rritja e popullsisë dhe urbanizimi, ndotja dhe ndryshimet klimatike – të gjitha këto çështje ndikojnë në tërë botën. OZHQ-të janë instrument i veçantë për t'i adresuar këto sfida globale në mënyrë të përbashkët. Kjo është një detyrë e ndërlikuar dhe kërkon përpjekje për bashkëpunim jo vetëm mes qeverive kombëtare por edhe mes autoriteteve vendore dhe rajonale dhe brenda tyre. Bashkëpunimi mes akterëve nga sektori privat dhe civil është i rëndësishëm më të lartë. Duke i përcaktuar 17 objektiva të qarta dhe të matshme, Agjenda 2030 ofron një udhërrëfyes për vitin 2030 të cilin të gjithë e ndajmë së bashku: qeveritë, qytetarët, bizneset, OJQ-të.

Një faktor i rëndësishëm i Agjendës 2030 është se i vendos njerëzit në qendër të procesit të zhvillimit. Ajo iu bën thirrje qeverive, parlamenteve dhe akterëve të tjerë për të hartuar dhe miratuar ligje dhe programe që i plotësojnë nevojat e njerëzve, i japin fund kulturës së elitizmit politik, përfshijnë më të cenuarit në shoqëri dhe respektojnë të drejtat e njeriut. Thënë shkurt, mesazhi kryesor është: **asnjë të mos lihet prapa.**



Burimi: Veprim për zhvillim të qëndrueshëm

2 Kush është përgjegjës për implementimin e OZHQ-ve?

Implementimi i Agjendës 2030 nuk është përgjegjësi e vetëm një qeverie apo institucioni të vetëm. Është një proces global me shumë akterë dhe të gjitha nivelet e qeverisjes janë përgjegjëse për arritjen e OZHQ-ve. Megjithatë, qeveritë kombëtare kanë mjetet dhe burimet për të planifikuar, prioritetizuar, financuar dhe zbatuar mënyrën se si OZHQ-të mund të arrihen në vendin e tyre. Në nivel ndërkombëtar, arritjet kombëtare të OZHQ-ve janë duke u monitoruar, përmes publikimit të të dhënave çdo vit në formën e renditjes globale.

Një parim i rëndësishëm lidhur me çështjen e përgjegjësisë është subvencionimi/

ndihmesa. Në mënyrë ideale, problemet duhet të zgjidhen sa më afër njerëzve. Në nivel rajonal dhe komunal, aktivitetet duhet të bazohen në ngritjen e kapaciteteve të akterëve lokalë, në themelimin e kornizave strategjike për zhvillim të qëndrueshëm, caktimin e kornizave politike dhe ligjore të veprimit si dhe sigurimin e një “qasjeje në të gjitha nivelet e qeverisë”. Burimet ekzistuese njerëzore në institucione të ndryshme do të lidhen së bashku për ngritur vetëdije dhe për ta implementuar Agjendën 2030. Kjo kërkon mobilizimin e të gjithë akterëve në shoqëri, për të siguruar një përfshirje më të gjerë shoqërore me qëllim që të përmirësohet cilësia e jetesës për të gjithë qytetarët.

3 Vështrim i përgjithshëm i OZHQ-ve – 17 objektivat

Agjenda 2030 përbëhet nga 17 Objektiva për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe 169 synime, të cilat maten përmes 231 treguesve. Tabela në vijim jep një pasqyrë të OZHQ-ve dhe objektivate të tyre konkrete.

Për informata të hollësishme lidhur me OZHQ-të në gjuhë të ndryshme, vizitoni ueb-faqet e tyre të mëposhtme:

Anglisht¹



Serbisht²



Boshnjake³



Maqedonisht⁴



Shqip⁵



- 1 <https://www.un.org/sustainabledevelopment/sustainable-development-goals/>
- 2 <http://www.rs.undp.org/content/serbia/sr/home/sustainable-development-goals.html>
- 3 http://www.ba.undp.org/content/bosnia_and_herzegovina/bs/home/post-2015.html
- 4 https://mk.rec.org/documents/news/Annex_II-b_-_Sustainable_Development_Goals_MKD.pdf
- 5 <http://acpd.org.al/wp-content/uploads/2015/09/Objektivat-e-Zhvillimit-te-Qendrueshem.pdf>

OZHQ**Përshkrim i objektivave**

Rritje e të hyrave për të varfërit, por edhe sigurimi i qasjes në shërbimet themelore dhe mbrojtja e të gjithëve nga fatkeqësitë e shkaktuara nga njeriu dhe nga ato natyrore



Të siguruarit se të gjithë mund të shijojnë të ushqyerit e sigurtë dhe me vlera ushqyese, gjatë tërë vitit



Të ndihmohen njerëzit që të jetojnë jetë të gjatë dhe të shëndoshë



Ofrimi i mundësisë që të gjithë të studiojnë, të mësojnë dhe ta përmbushin potencialin e tyre të plotë

OZHQ**Përshkrim i objektivave**

T'i jepet fund dhunës dhe diskriminimit ndaj grave dhe vajzave dhe të sigurohet që ato kanë mundësi të barabarta në të gjitha fushat e jetës



Të siguruarit se të gjithë kanë qasje në ujë të pijshëm të pastër dhe në objekte të toaletit



Të siguruarit se të gjithë kanë qasje në energji të gjelbër



Krijimi i vendeve të mira të punës dhe mundësive ekonomike për të gjithë









OZHQ	Përshkrim i objektivave	OZHQ	Përshkrim i objektivave
	Të siguruarit se të gjithë kanë infrastrukturën që u nevojitet për t'u lidhur me pjesën tjetër të botës		Mbrojtja e bregdeteve dhe oqeaneve
	Zvogëlimi i boshllëkut në mes të të pasurve dhe të varfërve		Mbrojtja e burimeve tona natyrore dhe botës së egër
	Vendosja e qyteteve në qendër të zhvillimit të qëndrueshëm në një botë të urbanizuar		Mbrojtja e njerëzve dhe të siguruarit se qeveritë punojnë në mënyrë efektive dhe të drejtë
	Zvogëlimi i ndikimit tone në planet duke prodhuar dhe konsumuar vetëm çfarë na nevojitet		Bashkëpunim në nivel global për t'i arritur OZHQ-të dhe për ta bërë realitet Agjendën pas vitit 2015
	Trajtimi i efekteve të ngrohjes globale		


Tabela 1: Vështrimi i OZHQ-ve dhe objektivat e tyre

4 Hyrja në BE dhe Agjenda 2030

Përmes procesit të saj të zgjerimit, BE-ja përkrah shtetet kandidate për t'i përforcuar institucionet e tyre dhe për t'i harmonizuar politikat e tyre me vlerat dhe parimet e BE-së. Procesi i hyrjes në BE përbëhet nga 33 kapituj të ndërlidhur me Acquis Communautaire (Ligji i Bashkimit Evropian). Nga shtetet kandidate pritet t'i inkorporojnë vlerat e BE-së në shoqërinë e tyre përmes zhvillimit të një sistemi ligjor dhe politik si dhe përmes ngritjes dhe përforcimit të institucioneve shtetërore.

Ndryshe nga procesi i hyrjes në BE, përqendrimi i Agjendës 2030 është tek njerëzit dhe tek një mënyrë e qëndrueshme jetese. Edhe pse të dyja politikat mund të duken të kundërta, në realitet ato përshtaten mjaft mirë. Pra, zhvillimi i qëndrueshëm është në thelb të Strategjisë së Evropës 2020 e cila bazohet në tre shtylla të rritjes, të cilat i pasqyrojnë tre dimensionet e zhvillimit të qëndrueshëm:

- ▶ **Rritje e mençur** përqendrim në promovimin e arsimit dhe inovacionit
- ▶ **Rritje e qëndrueshme** përqendrim në emetimin e ulët të karbonit, luftim të ndryshimeve klimatike dhe mbrojtje të mjedisit
- ▶ **Rritje gjithëpërfshirëse** përqendrim në krijimin e vendeve të reja të punës dhe ulje të varfërisë



- Rritje e mençur
- Rritje e qëndrueshme
- Rritje gjithëpërfshirëse



Zhvillim i qëndrueshëm

Burimi: KDZ 2019


Për shkak të përkushtimit të BE-së për zhvillim të qëndrueshëm, implementimi i Agjendës 2030 dhe hyrja në BE krijojnë efekte ndërlidhjeje për të dyja proceset. Një numër i OZHQ-ve janë të ndërlidhura me vlerat dhe partimet të cilat shtetet kandidate janë duke u munduar t'i arrijnë përmes procesit të hyrjes në BE. Për shembull, OZHQ 16 – arritja e krijimit të shoqërive paqësore dhe gjithëpërfshirëse, sundimit të ligjit, institucioneve efektive dhe të afta mund të ndërlidhet lehtësisht me kapitullin 23 mbi negociatat – të drejtat gjyqësore dhe themelore. Poashtu, kapitulli 11 – zhvillimi bujqësor dhe rural ndërlidhet me disa prej OZHQ-ve: OZHQ 2 – zero uri, OZHQ 5 – barazi gjinore, etj.

Kjo tregon se duke i arritur OZHQ-të, shtetet kandidate në të njëjtën kohë edhe i përmbushin përkushtimet e tyre drejt hyrjes në BE, që është synim strategjik i të gjitha vendeve të Ballkanit Perëndimor. Prandaj, implementimi i OZHQ-ve e përkrah procesin e integritimit në BE. Për hollësi lidhur me mënyrën se si OZHQ të caktuara ndërlidhen me kapitujt e Ligjit të BE-së, i referohemi shtojcës.



2

**Ndikimi i
OZHQ-ve në
komuna**



1 Si ndikojnë OZHQ-të tek komunat?

Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm mundësojnë vizion të qëndrueshëm të zhvillimit urban. Ky vizion i ri siguron mundësi të barabarta për të gjithë qytetarët, promovon një mjedis të shëndoshë të jetesës dhe i qëndrueshëm ndaj krizave dhe ndryshimeve klimatike. Komunat janë drejtpërdrejt përgjegjëse për zbatimin e një numri të konsiderueshëm të detyrave për realizimin e OZHQ-ve, në pajtim me zotimet e qeverisë kombëtare. Rreth 65 përqind të objektivave të Agjendës 2030 nuk do të mund të realizoheshin plotësisht pa kontributin e qeverive rajonale dhe vendore (rreth 70% e Ligjit të BE-së poashtu zbatohet në nivel lokal). Prandaj, është e rëndësishme së lartë që komunat të mos jenë vetëm zbatuese të strategjisë globale ose kombëtare të OZHQ-ve. Ato duhet të jenë më shumë partnere në themelimin dhe përcaktimin e politikave dhe programeve të OZHQ-ve, si dhe në realizimin dhe monitorimin e progresit në arritjen e OZHQ-ve.

Ish-Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së, Ban Ki-moon theksoi se Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm janë “Agjenda e Njerëzve”. Qeveritë lokale, si niveli më i afërt me qytetarët, bartin një pjesë të madhe të përgjegjësisë për t’u siguruar që OZHQ-të nuk e përjashtojnë asnjë person apo zonë. Prandaj, vlerat e shtuara potenciale për komunat janë:

- ▶ OZHQ-të ndihmojnë në rritjen e prosperitetit, në promovimin e gjithëpërfshirjes shoqërore, në reagimin ndaj ndryshimeve klimatike dhe në përmirësimin e qëndrueshmërisë mjedisore në komunë. Një jetë më e mirë për qytetarët duhet të jetë ndikimi kryesor i Agjendës 2030.
- ▶ OZHQ-të paraqesin një agjendë praktike dhe të dobishme për udhëheqësit politik dhe administrativ në komuna.
- ▶ Me OZHQ-të, strategjitë komunale mund të vlerësohen dhe të zhvillohen më tutje bazuar në synimet, treguesit dhe sfidat globale. Në këtë proces, mund të zbulohen paqartësi të mundshme në strategjitë lokale.
- ▶ Një kulturë e re partneriteti mund të themelohet mes administrates komunale, zyrtarëve të zgjedhur, palëve të interesit dhe qytetarëve për t’u marrë me sfidat globale dhe vendore.
- ▶ Komuna do të fitojë partnerë të rinj dhe do ta rrisë rrjetin e saj ndërkombëtar. Poashtu mundësi të reja për financimin e aktiviteteve komunale do të lidhen me OZHQ-të.
- ▶ **Thënë shkurt, puna me OZHQ-të e bën komunën një vend më tërheqës për të jetuar, për të investuar dhe për të filluar biznese të reja. Imazhi i komunës do të përmirësohet. Unapreduje se imidž opštine.**

Siç është pranuar nga përfaqësues të mirënjohur dhe të lartë shtetëror në Panelin e Nivelit të Lartë të personave të spikatur gjatë Agjendës për Zhvillim Pas Vitit 2015:

”

“Qytetet janë vendet ku do të humbet ose fitohet beteja për zhvillim të qëndrueshëm”

2 Detyrat dhe aktivitetet komunale të ndërlidhura me OZHQ-të

16

Detyrat dhe përgjegjësitë e qeverive lokale janë të ndryshme në vende të ndryshme. Megjithatë, ekzistojnë disa detyra që janë karakteristike pothuajse për çdo nivel lokal, sidomos në rajonin e Ballkanit Perëndimor, si: planifikimi hapësinor, mirëqenia sociale, mirëmbajtja e rrugëve lokale, transporti publik dhe menaxhimi i mbeturinave, ujit dhe kanalizimit. Zbatimi i këtyre detyrave mund të kontribuojë në arritjen e synimeve të OZHQ-ve, edhe nëse kjo nuk është e dukshme në shikim të parë. Nuk kërkon përpjekje shtesë përveç harmonizimit të politikave dhe procedurave që tashmë janë në fuqi si dhe monitorim dhe raportim adekuat të rezultateve.

Për shembull OZHQ 3 – të siguruarit e jetës së shëndoshë dhe promovimi i mirëqenies për të gjithë në të gjitha moshat – tregon rëndësinë e qeverive lokale

për zbatimin e OZHQ-ve. Edhe pse kujdesi shëndetësor në një vend të caktuar mund të mos jetë kompetencë e qeverive lokale, ato megjithatë duhet të kontribuojnë në jetën e shëndoshë të qytetarëve të tyre në shumë mënyra të tjera brenda kompetencave të tyre. Për shembull, duke ofruar ujë të pastër dhe kanalizim, duke futur në përdorim transport publik që do ta ulë ndotjen e ajrit ose duke i bërë rrugët lokale më të sigurta. Kjo lloj lidhjeje me kompetencat lokale mund të bëhet lehtësisht për cilindo OZHQ i cili, përsërisim, i bën qeveritë lokale ndërmjetësit kryesorë të zhvillimit të qëndrueshëm. Prandaj, pa asnjë dyshim në çdo OZHQ ka një dimension lokal.

3 #LOKALIZIMI I OZHQ-ve – hapat themelorë për implementimin e Agjendës 2030

Lokalizimi i OZHQ-ve nënkupton që secili komunitet lokal duhet t'i përshtatë OZHQ-të në kontekstin e vet dhe t'i marrë parasysh mënyrat se si OZHQ-të mund të arrihen përmes zbatimit të detyrave dhe përgjegjësi të rëndomta. Në fakt, lokalizimi i OZHQ-ve është ndryshimi më i rëndësishëm në paradigëm në Agjendën 2030 krahasuar me OMZH-të, të cilat nuk arritën të nxjerrin rezultatet e pritura kryesisht për shkak të qasjes së tyre nga lart poshtë.

Është përgjegjësi e secilit vend dhe komunave të tyre të vendosin se si do t'i implementojnë ato OZHQ-të dhe cilat procese do të jenë të duhura për t'i arritur rezultatet. Hapat kyç për fillimin e suksesshëm të lokalizimit të Agjendës 2030 dhe OZHQ-ve në komuna janë

Ky Doracak përqendrohet në dy hapat e parë të ciklit të implementimit, gjegjësisht në ndërgjegjësimin dhe krijimin e agjendës lokale për OZHQ-të. Këta kapituj përmbajnë edhe mjete praktike dhe shembuj nga jeta reale që mund të përdoren si inspirim.

Hapi 1 Ndërgjegjësimi për OZHQ-të:

Ndërgjegjësimi nënkupton se të gjitha palët e interesit duhet t'i kuptojnë OZHQ-të dhe të angazhohen në një dialog të gjerë që nxit pjesëmarrje dhe është gjithëpërfshirës. Zbatimi i suksesshëm kërkon përkrahje publike dhe angazhim si dhe përkushtim afatgjatë.

Hapi 2 Krijimi i agjendës lokale për OZHQ: :

Autoritetet lokale së bashku me përfaqësues nga sektori civil dhe privat duhet t'i priorizojnë objektivat dhe synimet globale për kontekstin e tyre lokal. Pastaj, OZHQ-të e priorizuar duhet të integrohen në strategjitë ekzistuese lokale dhe hapat e ardhshëm konkret duhet të përcaktohen në formë të një plani veprimi dhe të komunikohen gjerësisht.

Hapi 3 Planifikimi i implementimit të OZHQ-ve:

Nevojitet planifikim i bazuar në objektiva i cili kërkon një perspektivë afatgjatë. Politikat duhet t'i balancojnë vlerësimet sociale, ekonomike dhe mjedisore dhe të menaxhojnë konfliktet e mundshme.

Hapi 4 Monitorimi dhe vlerësimi:

Në fund, për të pasur mundësi të ndjeket procesi dhe të sigurohet llogaridhënie, duhet të vendosen korniza të monitorimit dhe vlerësimit. Ndikimi dhe efekti i tyre mund të matet vetëm duke i shqyrtuar programet dhe politikat si dhe duke i përshtatur politikat nëse ka nevojë.

17

#LOCALIZING SDGS

#LOKALIZACIJA CILJEVA ODRŽIVOG RAZVOJA

#ЛОКАЛИЗАЦИЈА ЦИЉЕВА ОДРЖИВОГ РАЗВОЈА


#LOKALIZIMI I OBJEKTIVAVE TË ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM

#ЛОКАЛИЗАЦИЈА НА ЦЕЛИТЕ ЗА ОДРЖЛИВ РАЗВОЈ



3

**PNdërgjegjësimi
për OZHQ-të**



1 Roli i qeverive lokale

Pasi që qeveritë lokale janë më së afërmi me qytetarët, njohuritë e tyre lokale janë shumë të vlefshme për implementimin e objektivave global në komunitetet e tyre. Jo vetëm që mund t'i identifikojnë nevojat më urgjente dhe boshllëqet zhvillimore në zonën e tyre, por autoritetet lokale kanë edhe një pasqyrë të akterëve më të rëndësishëm. Qeveritë lokale mund ta përdorin rrjetin e tyre për të komunikuar me akterët përkatës në shoqërinë civile dhe në sektorin privat. Kombinuar me resurset publike, një komunë ose qytet mund të nisë një dialog për t'u siguruar se njerëzit mësojnë dhe i kuptojnë OZHQ-të dhe se si sfidat globale që mund të duken të pamundura mund të trajtohen në nivel lokal.

2 Hapat e ndërgjegjësimit

Partnerët e mundshëm

- ▶ Këshillat lokal
- ▶ Mediat lokale
- ▶ Sindikatat profesionale
- ▶ Shkollat
- ▶ Universitetet
- ▶ Bizneset lokale
- ▶ Kompanitë e shërbimeve
- ▶ Shërbimet sociale
- ▶ Institucionet publike
- ▶ Kompanitë publike
- ▶ Dhoma e Tregtisë
- ▶ Sektori i OJQ-ve
- ▶ Shoqata e ndërmarrësve

Kutia 2: Shebmuj të partnerëve

Hapi 1 Informimi i stafit komunal dhe zyrtarët e përzgjedhur për OZHQ-të

Është qenësore të fillohet me informimin e stafit dhe zyrtarëve të zgjedhur lidhur me Agjendën 2030. Punëtorët komunal dhe shërbyesit civil jo vetëm që duhet të jenë të vetëdijshëm për vlerën e lokalizimit të OZHQ-ve, por duhet edhe të besojnë në vlerën e tyre të shtuar për komunitetin e tyre. Vetëm kështu ata do të mund ta ndajnë vërtetë përkushtimin dhe entuziazmin e tyre me qytetarët.

Hapi 2 Inkorporimi i OZHQ-ve në mjetet komunale të komunikimit dhe informimi i publikut

Pas fushatës informuese brenda organizatës, komuna duhet ta inkorporojë përkushtimin ndaj OZHQ-ve edhe në forma të ndryshme të komunikimit të jashtëm komunal. Kjo mund të variojë nga vënia në dispozicion e informatave në uebfaqen e komunës, në printimin e logos së OZHQ-ve në dokumentet komunale, në përfshirjen e vegëzave dhe referencave në nënshkrimet në e-mail. Poashtu, qytetarët duhet të informohen drejtpërdrejtë lidhur me Agjendën 2030.

Hapi 3 Nisja e një dialogu me bazë të gjerë

Hapi i tretë është nisja e një dialogu të gjerë dhe transparencës në të gjitha veprimet. Kjo siguron angazhim dhe përfshirje të shoqërisë civile, OJQ-ve, bizneseve lokale, komunitetit akademik dhe partnerëve të tjerë lokal. Kur të gjithë përfaqësuesit relevant kanë mundësi të kontribuojnë në një diskutim të hapur me pikëpamjet, njohuritë dhe përvojat e tyre të zhvillimit të qëndrueshëm sipas nevojave dhe prioriteteve lokale, procesi fiton legjitimitet. Prandaj, ky proces duhet të jetë ndërveprues dhe të përdorë një qasje të dialogut transparent dhe gjithëpërfshirës.

Hapi 4 Themelimi i grupeve partnere

Hapi i fundit është themelimi i grupeve të përhershme partnere në komunë. Grupet partnere përbëhen nga anëtarë të sektorëve privat, publik dhe civil së bashku me përfaqësues të administratës komunale. Përfaqësuesit e administratës komunale caktohen nga shefi i administratës ose kryetari i komunës përderisa përfaqësuesit e sektorit jo-publik mund të caktohen përmes shpalljes publike.

Grupet partnere themelohen në mënyrë të tillë që përfaqëson një mjedis të mirë të punës për një proces pjesëmarrës të përcaktimit të kornizave dhe aktiviteteve strategjike në nivel të komunitetit lokal në përputhje me nevojat e qytetarëve. Një diskutim i gjerë brenda kornizës së grupeve partnere ia mundëson komunitetit lokal të bëjë plane dhe të marrë vendime në interes të komunitetit në mënyrë më transparente dhe reale. Një shembull i mënyrës së themelimit të grupeve partnere përmes marrëveshjeve formale mund të gjindet në shtojcë.

Ky hap i fundit i ndërgjegjësimit krijon edhe bazën për rendin e ardhshëm në ciklin e lokalizimit të OZHQ-ve të paraqitur në kapitullin IV “Themelimi i agjendës lokale të OZHQ-ve”.

Shembull Bijeljina:

Krijimi i grupeve partnere për 3 shtylla të zhvillimit të qëndrueshëm:
Zhvillim ekonomik, zhvillim social,
zhvillim mjedisor

Kutia 3: Shembull Bijeljina

Dobitë e procesit të ndërgjegjësimit për OZHQ-të janë:

- ▶ stimulon **pjesëmarrje në procesin e implementimit**
- ▶ ofron **përkrahje politike** për Agjendën e Zhvillimit të Qëndrueshëm
- ▶ rrit **koherencën politike** mes akterëve, gjë që shpie në ulje të barrierave dhe konflikteve në fazën e implementimit
- ▶ promovon **bashkim** të përpjekjeve të akterëve të ndryshëm dhe përmirësim të **mundësive për financim** dhe kapacitete teknike përmes partneriteteve
- ▶ siguron **gjithëpërfshirje të grupeve dhe komuniteteve të marginalizuara**, duke mundësuar pjesëmarrjen e tyre në proceset e zhvillimit

3 Mjetet e ndërgjegjësimit

22

Promovimi i Agjendës 2030 dhe OZHQ-ve mund të bëhet pothuajse në çdo rast kur qeveria lokale është duke komunikuar brenda saj ose me publikun e përgjithshëm. Mund të përdoren objekte, piktograme, ushqim, fjalë, etj. Pjesa në vijim ofron një pasqyrë të mjeteve tashmë të testuara për promovimin e OZHQ-ve dhe Agjendës 2030. Secili mjet ndërlihet me një apo më shumë hapa të nevojshëm për ndërgjegjësim, gjë që formon bazën për hapat e ardhshëm në ciklin e lokalizimit të OZHQ-ve.

Mjetet e propozuara janë klasifikuar sipas 4 hapave të ndërgjegjësimit, varësisht nga hapi për të cilin janë më të përshtatshme⁶

Të gjitha mjetet e paraqitura në këtë doracak janë tejet fleksibile. Varësisht nga mjedisi i zgjedhur, niveli i hollësive dhe pjesëmarrësit, secili mjet mund të jetë i përshtatshëm për më shumë se një hap të procesit të ndërgjegjësimit, siç tregojnë këto katër simbole:



Mjetet e përshkruara në kapitullin IV përqendrohen në hollësitë e gjetjes së nevojës specifike për veprim në nivel lokal. Kur bëhen të thjeshta, këto mjete të gjithanshme mund të jenë të dobishme edhe për disa hapa të procesit të ndërgjegjësimit. Prandaj, këto katër simbole do t'i hasni përsëri në kapitullin IV.

⁶ Ikonat e përdorura në këtë kapitull janë bërë nga Freepik nga www.flaticon.com

3.1 Hapi 1: Informimi i stafit komunal dhe zyrtarëve të përzgjedhur për OZHQ-të



Hapi i parë është të informohen dhe angazhohen personat të cilët drejtpërdrejt do ta shtyejnë përpara procesin e lokalizimit të OZHQ-ve. Për ta përkrahur bashkëpunimin ndërrikasterial dhe jopartiak si themel për qeverisje lokale të cilësisë së mirë, është e rëndësishme të përdoren kanale të ndryshme të komunikimit.

Mjetet për komunikim të brendshëm

- Informata lidhur me OZHQ-të (dhe ftesa e inicimit/nisjes) përmes mesazheve periodike, ditëve të caktuara ose takimeve të punës

Informatat lidhur me Agjendën 2030 duhet të komunikohen rregullisht dhe punonjësit duhet të mbahen të informuar lidhur me strategjitë, veprimet dhe progresin komunal mbi këtë temë.

- Informata lidhur me OZHQ-të dhe qasjen e planifikuar komunale në një organizim të veçantë

Një organizim i veçantë, teorikisht i detyrueshëm për tërë stafin, me një mjedis si prezantim ose punëtori lejon një diskurs më të thellë lidhur me OZHQ-të. Tashmë mund të përcaktohen hapat e mëtejme dhe mund të formohen grupet punuese.



Burimi: KDZ 2018

3.2 Hapi 2: Inkorporimi i OZHQ-ve në mjetet komunale të komunikimit dhe informimi i publikut



Me këto ndryshime të thjeshta në strategjinë komunale të komunikimit, idetë e OZHQ-ve mund të zgjasin shumë. Tregojuni përkushtim komunave tuaja për kauzën e zhvillimit të qëndrueshëm!

Mjetet për komunikim të jashtëm

► Logoja komunale e OZHQ-ve dhe përdorimi i ikonave



Një logo komunale e OZHQ-ve mund të përdoret në shumë mënyra të ndryshme si pjesë e shënimeve në korrespondencë, e shfaqur në uebfaqen e komunës, e paraqitur në lokalet zyrtare, etj. Ikona e vogël por e dukshme e OZHQ-ve mund të shtohet në çdo dokument komunal, duke treguar marrëdhënien e aktiviteteve të komunës me OZHQ-të. Ajo paraqet dedikimin e komunës për t'i arritur OZHQ-të dhe në të njëjtën kohë përhapë informata lidhur me OZHQ-të.⁷

► Informata lidhur me OZHQ-të në uebfaqen komunale

Informata lidhur me OZHQ-të mund të shtohen në përmbajtjen e rregullt të uebfaqes me informata bazike për origjinën dhe qëllimin e OZHQ-ve si dhe vegëza për uebfaqe të tjera të cilat përmbajnë më shumë informata të hollësishme.

► Nënshkrimet OZHQ në e-mail



Logoja e OZHQ-ve mhet në çdo e-mail të dërguar nga punonjësit e komunës.

⁷ Variacione të ndryshme të logove të OZHQ (përfshirë rrotën e ngjyrave dhe 17 ikonat) mund të shkarkohet falas në 6 gjuhë në <https://www.un.org/sustainabledevelopment/news/communications-material/>



Burimi: Qyteti Bijeljina

► Ambasadorët e OZHQ ose zërat e OZHQ

Komunat mund të emërojnë individë të rëndësishëm si ambasadorë të OZHQ-ve të cilët do ta promovojnë zhvillimin e qëndrueshëm dhe OZHQ-të përmes punës së tyre të përditshme dhe marrin pjesë në debate të ngjashme. Poashtu, OZHQ-të përkatëse dhe proaktive mund të angazhohen për të vepruar si zëra të OZHQ-së të cilët do ta marrin përsipër shpërndarjen e informatave për OZHQ-të (shih filmin e shkurtë për zërat e OZHQ8).



Burimi: Weber / SDG Watch Austria ©

⁸ <https://www.sdg.be/nl/sdg-voices>

Mjetet për vizualizim dhe promovim

► Vizualizimi i OZHQ-ve duke krijuar dhe shpërndarë materiale për përdorim të përditshëm



Një komunë mund ta rrisë ndërgjegjësimin për OZHQ-të duke iu dhënë punonjësve dhe partnerëve produkte të OZHQ-së si **simbole** të OZHQ, **afishe** për dritare ose laptopë apo **çanta** me logo të OZHQ-së për përdorim të përditshëm. Bufetë/kafeteritë lokale poshtu mund të përdorin **shtroja për pjata** me OZHQ kur shërbejnë shujta. Këto masa synojnë të tërheqin vëmendjen e stafit dhe publikut vazhdimisht.



Burimi: Qyteti i Bijeljines

► Vizualizimi i OZHQ-ve në shkallë më të lartë

Një mundësi tjetër është përdorimi i hapësirave publike për ta shfaqur përkushtimin e komunës për zhvillim të qëndrueshëm. **Posterat e OZHQ-ve** mund të printohen në madhësi të ndryshme, nga një për secilin OZHQ ose të gjithë në një poster. Një mundësi tjetër është përdorimi i **flamujve të OZHQ-së**. Flamuj të thjeshtë të shumëngjyrshëm mund të dizajnohen dhe të paraqiten në lokalet e komunës, gjatë festivaleve, në rrugë e të ngjashme (shih një shembull të një flamuri këtu⁹).

9 <https://shop.undp.org/products/sdgs-flag>



Burimi: Kombet e Bashkuara BiH ©

► Vënia në dispozicion e informatave më të hollësishme, të gjeshme dhe të kuptueshme



Nëse punonjësit, qytetarët, partnerët dhe akterët e tjerë duan të dinë më shumë për OZHQ-të, informata më të hollësishme duhet të ofrohen shpejt dhe lehtë. Për shembull, një komunë mund të përdorë **cheat sheets** të OZHQ-ve, të cilat janë paraqitje vizuale dhe tekstuale e OZHQ-ve që ofrojnë informata bazike në një minutë apo dy (cheat sheet në gjuhën angleze mund të shkarkohen falas këtu¹⁰).

Broshurat klasike dhe hollësi të tjera lidhur me OZHQ-të mund të vendosen pothuajse në çdo hapësirë të lokaleve të komunës: në korridore, toaleta, pranë makinave të kafesë dhe të tilla. Në kohë të shpërndarjes së informatave audio-vizuale, mund të krijohet një **video e shkurtë për OZHQ-të** në gjuhën amëtare me informata lidhur me OZHQ-të dhe rolin e autoriteteve lokale në arritjen e tyre. Videoja mund të vendoset në rrjetet sociale si dhe të prezantohet në ekranet e videove në lokalet e komunës (shih shembullin e një filmi në gjuhën angleze këtu¹¹).

10 <https://www.cheatography.com/davidpol/cheat-sheets/17-sustainable-development-goals/>

11 <https://www.youtube.com/watch?v=6B2luZCuwec>

3.3 Hapi 3: Nisja e një dialogu me bazë të gjerë



Tashmë është zbatuar një numër i ideve të shkëlqyeshme për organizime stimuluuese të ndërlidhura me OZHQ-të.

Veprime dhe organizime për ta filluar dialogun

► OZHQ-të në organizime komunale

Për hapin e tretë, nisja e një dialogu me bazë të gjerë është qenësor që qytetarët dhe partnerët të flasin për OZHQ-të. Vendosja e foltoreve në organizime lokale mund të ndihmojë në përfshirjen dhe në interesimin e publikut të përgjithshëm për OZHQ-të. Interesimi mund të shtohet duke ofruar **lojëra ose pyetje kuizi** për të nxitur ndërveprim.

Një mundësi tjetër është vendosja e një kutie në çdo vend-ndodhje të organizimit ose objekt komunal, një **“kabinë kohe”** ku qytetarët mund t'i shkruajnë dëshirat, pritshmëritë dhe idetë e tyre për atë se si do të duket botanë vitin 2030. Ky është një mjet i shkëlqyeshëm ndërgjegjësimit edhe mes institucioneve arsimore.

Një opsion tjetër është vendosja e një **ekzpozite me fotografi**, ku paraqiten fotografi, video dhe/ose art i personave dhe nismave lokale duke treguar historitë e tyre dhe si ata kontribuojnë në OZHQ-të.



Burimi: Kombet e Bashkuara BiH ©



Burimi: Kombet e Bashkuara BiH ©

- Punëtoritë në lidhje me OZHQ-të



Punëtoritë mund të organizohen për punonjësit komunalë për t'i përmirësuar njohuritë e tyre në lidhje me OZHQ-të ose për të këmbyer informata se si puna e tyre e rregullt kontribuon në arritjen e OZHQ-ve. Punëtoritë jo vetëm që mund të mbahen brenda komunës, por mund të zgjerohen për të përfshirë akterë të ndryshëm dhe grupe partnere. Varësisht nga organizata dhe agjenda, punëtoritë si mjet shumë fleksibil mund të jenë të përshtatshme për të gjithë hapat e ndërgjegjësimit. Disa ide për mënyrën e organizimit të punëtorive të shkurta me ndihmën e mjeteve ndërvepruese mund të gjinden në nënkapitullin në vijim.

3.4 Hapi 4: Krijimi



i grupeve partnere

Grupet partnere ndërdisiplinore mund të themelohen në organizime publike ose mjedise punëtorish, themelimi i suksesshëm i grupeve partnere si dhe përgjegjësite e tyre dhe hapat e ardhshëm duhet të shpallen publikisht. Ky hap i fundit i ndërgjegjësimit e plotëson pjesën e parë të ciklit për lokalizimin e OZHQ-ve siç është paraqitur në kapitullin II.3. Përshkrimi i mjeteve të caktuara për ta thellësuar punën e grupeve partnere dhe për t'i caktuar veprimet e mundshme mund të gjindet në kapitullin IV.3.

Kutia e bisedave OZHQ



Kategoria e mjetit:	Dialogu
Kohëzgjata:	2 orë (varësisht nga numri i pjesëmarrësve, një seancë zgjatë minimumi 30 min)
Pjesëmarrësit e mundshëm:	çdo individ, nga qytetarët deri tek akterët lokal
Materialet e nevojshme:	karta me pyetje lidhur me OZHQ, karrige, tavolina, (materiale të printuara të objektivave dhe synimeve nëse nevojitet shpjegim)
Objektivi/rezultatet:	Fillimi i dialogut me bazë të gjerë
Zhvilluar nga:	Komuna e Dilsen-Stokkem (Belgjikë)

Procedura:

Filloni me përgatitjen e një ambienti të rehatshëm: një tavolinë me karta me pyetje lidhur me OZHQ-të, mbase disa kafe ose pije tjera, karrige dhe një moderator. Dy a më shumë pjesëmarrës ulen rreth tavolinës. Për ta mundësuar dialogun mes pjesëmarrësve, rekomandohen maksimum 4 pjesëmarrës për seancë.

Pas prezantimit, moderatori u parashtroi pjesëmarrësve pyetje në lidhje me OZHQ-të. Këto pyetje mund të mbulojnë fakte të përgjithshme për Agjendën 2030 dhe OZHQ-të, p.sh. në lidhje me synimet dhe nën-synimet e tyre. Poashtu, ata mund të përqendrohen në çështje botërore

dhe probleme globale që theksojnë rëndësinë e OZHQ-ve. Varësisht nga pjesëmarrësit dhe atmosfera, ky mjet mund të përdoret qoftë si format i thjeshtë kuizi ose të shndërrohet në format diskutimi.

Synimi kryesor i kësaj detyre është që qytetarët dhe çdo akter tjetër lokal të përfshihet në bisedën dhe diskutimin për OZHQ-të.

Nëse ka kohë, diskutimi mund të mbyllet me një reflektim mbi idetë dhe propozimet e pjesëmarrësve për veprime në nivel lokal.



Bisedimet aktive OZHQ



30

Kategoria e mjetit:

Dialogu për angazhimin e fëmijëve dhe rinisë

Kohëzgjatja:

2 orë

Pjesëmarrësit e mundshëm:

fëmijët, rinia, (idealisht të rinjtë, edhe të ngjashëm) ndryshim-bërësit lokal, që punojnë për OZHQ-të me ose pa e ditur (inovatorët, ndërmarrësit, aktivistët...)

Materialet e nevojshme:

Materiale të printuara të objektivave dhe synimeve të OZHQ-ve, karrige, të gjitha materialet me informata të disponueshme të përshtatshme për fëmijët dhe rininë

Objektivi/rezultatet:

Fillimi i dialogut me bazë të gjerë

Zhvilluar nga:

Ekipi i Agjendës 2030, Divizioni i UNICEF-it për Partneritete Publike

Procedura:

Përgatitni një mjedis të qetë, të rehatshëm në formë paneli dhe disa karrige. Audienca e synuar janë fëmijët e mëdhenj dhe të rinjtë, të cilët nuk janë përballur asnjëherë më parë me OZHQ-të apo që kanë vetëm një ide të mjegullt lidhur me Agjendën 2030 të OKB-së. Një përfaqësues i qeverisë ose administratës lokale thotë disa fjalë të shkurtra hyrëse për OZHQ-të e synuara dhe jep një kontekst të mënyrës se si të rinjtë mund të kontribuojnë në OZHQ dhe çfarë synon të arrijë Bisedimi aktivizues (varësisht nga folësi, përqendrohuni në disa OZHQ. Zbatimi do të jetë i thjeshtuar, nëse është një organizim tematik me përqendrim në një grup OZHQ-sh).

Pjesa kryesore e organizimit është një diskutim i moderuar në formë paneli me 4-5 folës “që po bëjnë ndryshim”. Ata e prezantojnë veten dhe punën e tyre për një minutë. Folësit duhet të përfundojnë fjalën e tyre me një koment duke treguar se a kanë ditur për OZHQ-të para organizimit dhe si ndërlidhet puna e tyre me OZHQ të caktuar. Prezantimet e shkurtra pasohen nga diskutime/Pyetje dhe Përgjigje me audiencën. Moderatorin duhet ta angazhojë audiencën në mënyrë aktive. Pyetjet mund të përqendrohen, për shembull, nëse audienca ka dëgjuar për OZHQ-të më herët, cilat prej veprimeve të tyre të përditshme ndikojnë në OZHQ-të e diskutuara dhe si mund të marrin pjesë ata aktivisht në promovimin e OZHQ-ve.

Në fund, rezultatet duhet të përmbledhen nga moderatori. Materialet me informata për OZHQ dhe artikuj tjerë të OZHQ si simbolet ose kartat e kuizit u shpërndahen pjesëmarrësve.

Për informata më të hollësishme për mënyrën e organizimit të bisedimeve aktivizuese, shikoni këtu¹².



¹² https://www.unicef.org/agenda2030/files/SDGActivateTalkMethodology_LocalYoungChangeMakers_final_v2.pdf

4 Shembuj nga Ballkani Perëndimor

4.1 Bijelinë (Bosnjë dhe Hercegovinë)

Qyteti i Bijelinës promovon dhe lokalizon Agjendën 2030 dhe OZHQ-të

Informata themelore

Iniciatorët: Qyteti i Bijelinës

Detajet e kontaktit:
AnkicaTodorović
(ankica.todorovic@gradbijeljina.org)
dhe Mile Pejčić (mile.pejdic@gradbijeljina.org)

Periudha kohore:
2017-2018

Akterët e përfshirë:
Administrata e Qytetit të Bijelinës

Përqendrimi (OZHQ-të e synuara): Të gjitha 17 OZHQ-të

Përshkrim i shkurtër:

Qyteti i Bijelinës vendosi të marrë qasjen “nga poshtë-lart” dhe filloi ndërgjegjësimin mes akterëve lokal në qytet në fillim të vitit 2017. Aktivitetet kryesore përfshijnë:

- ▶ Anketë për njohuritë lidhur me OZHQ-të me përfaqësuesit e sektorit publik, privat dhe civil.
 - ▶ Konsultime të realizuara me organizata relevante ndërkom-bëtare, duke përfshirë OKB-në në BiH, për qasjen e promovimit dhe lokalizimit të OZHQ-ve.
 - ▶ Është krijuar një koncept për promovim/ndërgjegjësim dhe lokalizim të Agjendës 2030/OZHQ-të
 - ▶ Trajnim i anëtarëve të stafit komunal për metodologjinë/mjetin ndërveprues të OKB-së në BiH që duhet të përdoret për trajnim mbi ndërgjegjësimin.
- ▶ Fillimi i seancave trajnuese për ndërgjegjësim me grupet partnere në nivel të qytetit të Bijelinës (të përbëra nga sektori privat, publik, civil dhe akademia) dhe akterë të tjerë
 - ▶ Lokalizimi i OZHQ-ve filloi në Bijelinë përmes zbatimit të projekteve konkrete në PARTNERITET me sektorin privat, publik dhe civil dhe akademi - p.sh. avancimi i aftësive të personave të papunësuar në përputhje me nevojat e sektorit privat; ndërtimi i parkut gjithëpërfshirës të lojërave për fëmijë me dhe pa aftësi të kufizuara; themelimi i orëve praktike për 7 profesione mungesë që nevojiten në tregun e punës; prezantim i 2 profesioneve të reja në shkollat profesionale, etj.
 - ▶ Përfshirja e OZHQ-ve në Strategjinë e Rishikuar të Zhvillimit të Qytetit të Bijelinës për periudhën 2019 - 2023.



Ndërgjegjësimi i grupeve të synuara:

Sektori privat, kompanitë private, sektori i OJQ-ve, akademia, përfaqësuesit e mediave – si shumëfishues të njohurisë dhe informatave të fituara tek grupet e tyre të synuara të cilat i përfaqësojnë.

Metodat dhe mjetet:

- ▶ Prezantim me Power Point për themelimin e Agjendës 2030/OZHQ-ve, rëndësisë së tyre dhe shembuj konkret të mënyrës se si të gjithë akterët e synuar mund të fillojnë të përfshihen, si qytetarë, si dhe si përfaqësues të institucioneve dhe organizatave që ata i përfaqësojnë.
- ▶ Aplikim i mjetit ndërveprues të OKB-së në B&H – puna në grupe.

4.2 Bijelinë (Bosnjë dhe Hercegovinë)

“Përmes partneritetit drejt zhvillimit të qëndrueshëm”

Informata themelore

Iniciatorët:

Administrata e Qytetit të Bijelinës

Detajet e kontaktit:

Ankica Todorović (ankica.todorovic@gradbijeljina.org) dhe Mile Pejčić (mile.pejdic@gradbijeljina.org)

Periudha kohore: 2018

Akterët e përfshirë:

Administrata e Qytetit të Bijelinës, kompanitë private “Megadrvo” dhe “StecoCentar”, OJQ “RotarAct”, ambasada e Zvicrës dhe ajo e Bullgarisë në B&H

Përqendrimi (OZHQ-të e synuara): OZHQ-të 10, 11, 17

Përshkrim i shkurtër:

Aktivitetet e ndërgjegjësimit për rëndësinë e Agjendës 2030/OZHQ-ve gjatë vitit 2017 në Qytetin e Bijelinës kanë çuar në konsolidimin e partnerëve për arritjen e veprimeve konkrete që do të promovonin shtyllat kryesore të Agjendës 2030. Iniciuar nga Administrata e Qytetit të Bijelinës dhe përkrahur nga dy kompani lokale private „Megadrvo“ dhe „StecoCentar“ dhe OJQ „RotarAct“, në Bijelinë është ndërtuar një park gjithëpërfshirës i lojërave për fëmijë në Parkun kryesor të qytetit në vitin 2018. Financiarisht, parku i lojërave është përkrahur nga ambasada zvicerane dhe ajo bullgare në B&H.

Para kësaj, vendi mund të përdorej vetëm nga një numër i kufizuar i fëmijëve për shkak se kërkohej tarifë e hyrjes dhe nuk kishte mundësi të lojës për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Rezultatet konkrete që u arritën, bazuar në OZHQ-të 10, 11 dhe 17:

- ▶ Park i qëndrueshëm, modern e i sigurt i lojërave – i ndërtuar nga druri i cilësisë së lartë „Arish Siberian“, nën mbikëqyrje me video
- ▶ Park gjithëpërfshirës i lojërave – i ndërtuar për t’u përshtatur fëmijëve me dhe pa aftësi zhvillimore
- ▶ Qasje e barabartë e mundësuar për të gjithë fëmijët

Ky projekt është një rezultat konkret i ndërgjegjësimit për rëndësinë e Agjendës 2030/OZHQ dhe paraqet veprime konkrete në lokalizimin e OZHQ-ve në partneritet për dobinë e komunitetit.



Grupet e synuara për ndërgjegjësim:

Sektori publik, kompanitë private, sektori i OJQ-ve, qytetarët.

Metodat dhe mjetet:

- ▶ Prezantim me Power Point për themelimin e Agjendës 2030/OZHQ-ve, rëndësisë së tyre dhe shembuj konkretë të mënyrës se si të gjithë akterët e synuar mund të fillojnë të përfshihen, si qytetarë, si dhe si përfaqësues të institucioneve dhe organizatave që ata i përfaqësojnë.
- ▶ Dialog dhe promovim i vazhdueshëm i OZHQ-ve në takime dhe kontakte me grupet e synuara të cekura më lartë.
- ▶ Tabelë e madhe informuese e vendosur në hyrje të parkut të lojërave, që promovon 17 OZHQ-të dhe partneritetin e sektorit publik, civil dhe privat.

4.3 Elbasan (Shqipëri)

Java e Objektivave Globale: Inovacioni – çelësi për arritjen e OZHQ-ve

Informata themelore

Iniciatorët: Komuna e Elbasanit dhe Agjencitë e OKB-së në Shqipëri

Detajet e kontaktit:
nuk ka

Periudha kohore:
Shtator 2017

Akterët e përfshirë:
Organizatave shoqërisë civile, rinia, Anëtarët e Këshillit Komunal

Përqendrimi (OZHQ-të e synuara): Të gjitha 17 OZHQ-të

Përshkrim i shkurtër:

Agjencitë e OKB-së në Shqipëri kanë organizuar kremtime të përvjetorit të dytë të miratimit të OZHQ-ve për javën e veprimeve, ndërgjegjësimit dhe llogaridhënies për zhvillim të qëndrueshëm. Është organizuar si seri organizimesh në Komunën e Elbasanit duke përfshirë organizime publike dhe mbajtje të orëve shtesë në shkollat publike.

Grupet e synuara për ndërgjegjësim:

Organizatave shoqërisë civile, rinia, anëtarët e këshillit komunal, qytetarët.

Metodat dhe mjetet:

- ▶ Një „Hackathon“ dy-ditor me pjesëmarrjen e të Rinjve të Elbasanit për të projektuar zgjidhje të shpejta të reja me një ndikim afatgjatë në arritjet e OZHQ-ve/zbatimin e platformave inovative me burim të hapur për zbatimin e OZHQ-ve.
- ▶ Takimi në Komunën e Elbasanit i titulluar “Elbasani 2030” ka shërbyer si platformë për këmbimin e ideve, për krijimin e partneriteteve, angazhimin e komuniteteve, ndërtimin e shkollave publike dhe nxitjen e veprimeve për arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm në nivel lokal.
- ▶ Mësimi më i Madh në Botë në dy shkolla publike në Elbasan. Nisma i solli OZHQ-të tek të rinjtë dhe mësuesit në mbarë botën. Organizimi kishte synim t’i bëjë OZHQ-të relevante për fëmijë kudo që janë dhe t’i inspirojë ata për përkrahje dhe veprim

4.4 Zemun (Serbi)

Manifestim publik për promovimin e OZHQ-ve

Informata themelore

Iniciatorët: Komuna e Zemunit (Serbi) dhe Offenbach am Main (Gjermani)

Detajet e kontaktit: Tanja Kukobat, tanja.kukobat@zemun.rs

Periudha kohore: 2018

Akterët e përfshirë: Komuna e Zemunit, Misioni i OKB-së në Serbi, Dhoma Serbe e Tregtisë, Shërbimi Kombëtar i Punësimit, Qendra për Punë Sociale, Fakulteti i Bujqësisë, Konferenca e Përhershme e Qyteteve dhe Komunave, Ministria e Punës, Punësimit, Veteranëve dhe Politikave Sociale, Drejtorët e Zyrave në Komunën e Zemunit, Parlamenti i Republikës së Serbisë etj.

Përqendrimi (OZHQ-të e synuara): 17 OZHQ-të

Përshkrim i shkurtër:

Manifestim Publik drejt zhvillimit të qëndrueshëm: përpjekje të përbashkëta nga Zemuni dhe Offenbach am Main

Të gjitha 17 shkollat e përzgjedhura kanë marrë detyrën e prezantimit të njërit prej OZHQ-ve. Nxënësit kishin për detyrë të analizonin përpjekjet dhe rezultatet e shkollave të tyre dhe komunitetit të tyre lokal në lidhje me zbatimin e OZHQ-ve dhe të bëjnë propozime se si ta bëjnë Agjendën 2030 më të dukshme në komunitetin e tyre dhe si të arrihet një OZHQ i caktuar. Nxënësve iu dhanë bluza me foto të shtypura të OZHQ-ve në anën e përparme dhe ata krijuan skuadra shkollore të cilat bënin prezantime para publikut. Nxënësit shfaqën nivel të lartë të ndërgjegjësimit, interesimit dhe kreativitetit, si dhe përgjegjësi dhe dëshirë për t'u marrë me çështjet e zhvillimit të qëndrueshëm.

Shumë performanca muzikore, performanca letërsie, informatat e shkurta nga profesori për OZHQ-të dhe performanca e nxënësve e bëri këtë organizim univerzal dhe të hapur për publikun, interesant dhe inspirues.

Materialet promociionale përfshinë broshura për OZHQ-të, fletore, lapsa dhe fletushka të cilat iu shpërndanë pjesëmarrësve dhe vizitorëve.

Grupet e synuara për ndërgjegjësim:

Fëmijët e shkollave nga shkollat fillore dhe të mesme, të moshuarit nga Shoqatat e të moshuarve, OJQ-të administrata e komunës, institucionet shtetërore autoriteti i të cilave përfshin Agjendën 2030, përfaqësues të Parlamentit Serb dhe të Ministrisë.

Metodat dhe mjetet:

Manifestim publik

4.5 Prizren (Kosovë)

Fuqizimi i të drejtave sociale të grupeve të marginalizuara në Komunën e Prizrenit

Informatat themelore

Iniciatorët: OJQ Nevo Koncepti, Grupi Punues Komunal (GP)

Detajet e kontaktit:

o.osmani@nevokoncepti.org,
blerinabytyqi06@gmail.com

Periudha kohore:

qershor 2017 – dhjetor 2018

Akterët e përfshirë:

OJQ, Anëtarët e GP komunal, ofruesit e shërbimeve, fëmijët, gratë, banorët

Përqendrimi (OZHQ-të e synuara):

OZHQ-të 1, 3, 4, 5, 10, 16, 17

Përshkrim i shkurtër:

Projekti kishte për qëllim të forcojë kapacitetet e të gjithë akterëve që ofrojnë shërbime për grupet e marginalizuara, ngritjen e nivelit të bashkërendimit ndërmjet palëve të interesit dhe ndërgjegjësim për rëndësinë dhe mbrojtjen e të drejtave të grupeve të marginalizuara. Qëllimi i përgjithshëm është të përmirësojë qasjen e grupeve të marginalizuara në shërbimet institucionale, duke siguruar mbështetje përmes ndërmjetësimit në procesin e qasjes së tyre në shërbimet sociale, shëndetësore, arsimore etj.

Ishin **16 debate në radio** në radio lokale në gjuhën rome dhe pjesëmarrësit ishin anëtarë të Grupit Punues, fëmijët që ndoqën aktivitete dhe trajnime ndërkulturore, studentë që morën pjesë në kurse për përgatitje për provimin e arritshmërisë dhe pjekurisë, ligjëruesit e kurseve si dhe anëtarët e familjeve vizitore. 7 debate televizive u zhvilluan me anëtarë të GP-së për TV lokale dhe u ofruan informata për shërbimet e ofruara nga institucionet lokale dhe mënyrën e qasjes së grupeve të marginalizuara në këto shërbime.

Janë organizuar **4 sesione trajnimi** me gratë dhe vajzat e reja të grupeve të marginalizuara. Trajnimet u mbajtën nga anëtarët e GP të projektit, të cilët kanë mundësuar ngritjen e kapaciteteve dhe njohurive mbi temat e trajnimeve që lidhen me nevojat e identifikuara në këto grupe. Çdo muaj, realizohen **takime të rregullta ndërgjegjësimi** me banorët e lagjeve, me qëllim të ndërgjegjësimit për të drejtat sociale dhe shërbimet e ofruara nga niveli lokal. Takimet ndihmohen nga anëtarët e GP-së. Janë realizuar **10 trajnime** me fëmijë për ngritjen e kapaciteteve dhe ndërgjegjësim në tema që lidhen me të drejtat e tyre. Pjesëmarrësit ishin fëmijë nga familjet e marginalizuara. **10 aktivitete ndërkulturore** me fëmijët janë mbajtur me qëllim të socializimit të fëmijëve nga komunitete të ndryshme dhe përfshirjen e tyre në një shoqëri të përbashkët.

Grupet e synuara për ndërgjegjësim:

Janë organizuar **kurse të gjera** për nxënësit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian për përgatitjen e testit të arritshmërisë dhe testit të maturës. Nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme u identifikuan për të ndjekur kursin njëmuajor për përgatitjen për teste. Pas provimit të maturës, u mbajt një kurs profesional orientimipër studentët e ardhshëm të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Janë realizuar **3 vizita këmbimi** me GP në komunat e Prishtinës, Ferizajt dhe Gjilanit. Grupet punuese shkëmbyen përvojat e tyre në lidhje me punën për adresimin e çështjeve të grupeve të marginalizuara. Gjatë këtyre vizitave, GP dhe stafi i projektit të Komunës së Prizrenit u dalluan për metodat e punës në terren dhe rastet e ndërmjetësimit në shërbimet institucionale. **3 tryeza diskutimi** janë mbajtur me anëtarët e Grupit Punues dhe ofruesit e shërbimeve sociale për grupet e marginalizuara dhe të gjithë akterët relevantë, mbi bashkëpunimin ndërmjet sektorëve dhe me të gjithë akterët relevantë në përmirësimin e shërbimeve dhe mbështetjen e grupeve të marginalizuara për qasjen e tyre në shërbimet institucionale.

OJQ-të, sektori publik, përfaqësuesit e mediave si shumëfishues të njohurive dhe informatave të fituara, fëmijët, gratë dhe banorët e tjerë.

Metodat dhe mjetet:

Aktivitete të gjëra sociale në media, debate në TV dhe radio, reklama të printuara, organizime publike të informimit, aktivitete të ndërgjegjësimit me fëmijë, gra dhe banorë të tjerë.

5 Shembuj ndërkombëtarë

5.1 Gent (Belgjikë)

Zërat e OZHQ-së: Gent

42

Informatat themelore

Iniciatorët: SHIFT (Rrjeti Belg i qëndrueshmërisë), Këshilli i Qytetit të Gentit

Detajet e kontaktit:
gentinfo@stad.gent

Periudha kohore:
2016-2017

Akterët e përfshirë:
23 departamente të qytetit, akterët ekonomikë, OJQ-të lokale, NP-të, banorët.

Përqendrimi (OZHQ-të e synuara): të gjitha OZHQ-të.

Përshkrim i shkurtër:

Projekti i ndërgjegjësimit filloi në vitin 2016, 17 ekspertë për zhvillim të qëndrueshëm nominuan 8 komuna dhe organizata si “zëra të OZHQ-ve”. këta “zëra” morën financime për të nisur projekte të komunikimit dhe pjesëmarrjes për të shpërndarë njohuri për OZHQ-të. Zëri lider i OZHQ-ve, Genti inicioi “Sfidën e Qëndrueshmërisë”, një seri garash me publicitet të lartë mes Zërave të OZHQ-ve lidhur me tema të ndryshme (çiklizmi, feminizmi, produktet pa mish dhe ato rajonale). Shumë projekte të tjera që kishin për synim përkrahjen e OZHQ-ve u nisën nga qyteti dhe akterët e tjerë e banorët gjatë dhe pas fushatës së caktuar.

Grupet e synuara për ndërgjegjësim:

Organizimet dhe projektet e ndryshme kishin në shënjestër banorët e qytetit të të gjitha moshave dhe prejardhjeve.

Metodat dhe mjetet:

- ▶ Gara: “lojëra”, komunat pjesëmarrëse, shkollat dhe organizatat garuan kundër njëra tjetrës për arritjen e ditëve më të gjata të të ushqyerit vetëm me perime, kilometrat e kaluar në çiklizëm ose ndërgjegjësim për temën e seksizmit, feminizmit dhe pabarazive me bazë gjinore. Rezultatet e ndërmjetme dhe pikët përfundimtare u komunikuan publikisht.
- ▶ Reklama të shumta në mediat sociale, TV dhe të printuara. Organizime publike të informimit dhe festa.

5.2 Shtuttgart (Gjermani)

Aktivite për ndërgjegjësim lidhur me qëndrueshmërinë

44

Informatat themelore

Iniciatorët: nismat dhe konsulencat lokale të qëndrueshmërisë, përkrahur pjesërisht nga administrata e qytetit.

Detajet e kontaktit: www.meinstuttgart-meinewelt.de, www.uebermorgen-markt.de, www.zirkusmuttererde.de

Periudha kohore: fushata e nisur në vitin 2017, tregu vjetor dhe festivali u organizuan për herë të parë në vitin 2016

Akterët e përfshirë: OJQ dhe OPN të ndryshme, institucionet arsimore, akterët ekonomik dhe banorët.

Përqendrimi (OZHQ-të e synuara): të gjitha 17 OZHQ-të (bazuar në një nocion më të gjerë të qëndrueshmërisë).

Përshkrim i shkurtër:

Katalizator për veprim lokal ishte nisma gjermane mbarëkombëtare “Ditët e Qëndrueshmërisë” që fokusohet në ndërgjegjësim për Agjendën 2030 të OKB-së dhe OZHQ-të. Fushata “Shtuttgarti Im Bota Ime” u nis nga nisma të ndryshme lokale, të përkrahura nga administrata e qytetit, për ta përkrahur zbatimin lokal të Agjendës 2030. Synimi kryesor i fushatës ishte t’i bëjë bashkë dhe të krijojë dialog të orientuar drejt veprimeve mes akterëve lokalë. Tregu vjetor “Übermorgen (e nesërmja) market” i përqendruar në prodhim dhe konsumim të qëndrueshëm u nis nga “Übermorgen Magazine” dhe një konsulencë lokale e qëndrueshmërisë. “Festivali Cirk Nëna Tokë” organizohet çdo vit nga një shoqatë private me qëllimin e ndërgjegjësimit dhe nxitjes së veprimit drejt një shoqërie më të qëndrueshme.

Grupet e synuara për ndërgjegjësim:

Organizimet e ndryshme kishin në shënjestër banorët e të gjitha moshave dhe prejardhjeve por tregu dhe festivali në mënyrë specifike kanë për synim të krijojnë një mundësi rrjetëzimi për lloje të ndryshme të nismave dhe akterëve social, ekonomik, kulturor dhe arsimor. Tregu dhe Festivali kanë një përqendrim të veçantë në aktivitetet për fëmijë dhe me fëmijë.



Metodat dhe mjetet:

- ▶ Lloje të ndryshme të organizimeve gjatë **fushatës**: Emisione të drejtpërdrejta të gatimit me politikanë, festa publike të këmbimit të rrobave, turne të udhëzuara nëpër qytet, shfaqje të filmave me diskutime ose javë tematike me institucione të ndryshme pjesëmarrëse, secila duke zhvilluar programin e vet.
- ▶ **“Übermorgen Market”**: Platformë për prodhuesit, shitësit dhe nismat lokale. Organizimi i tregut duke ndjekur kritere të qëndrueshmërisë (transporti, energjia elektrike, menaxhimi i ujërave dhe kanalizimit, materialet e riciklueshme, enët etj). Kabina të informimit dhe shitjeve, të përcjellura me punëtori, muzikë dhe seanca gatimi për personat në nevojë.
- ▶ **Festivali Cirk Nëna Tokë**: Platformë për nismat lokale, organizatat e bamirësisë, objektet arsimore. Muzikë, informata, treg gjërash të lira, lojëra edukative, punëtori.

5.3 Vienë (Austri)

Ndërgjegjësimit për dhe përmes Agjendës Lokale 21+ në Vienë

Informatat themelore

Iniciatorët: administrata e qytetit dhe këshilli i qytetit, Agjenda21 + zyrat e qarkut.

Detajet e kontaktit: www.la21.wien.at

Periudha kohore: LA21 nisi në vitin 1998.

Akterët e përfshirë: palët lokale të interesit, akterët ekonomik, qytetarët.

Përqendrimi (OZHQ-të e synuara): të gjitha 17 OZHQ-të (bazuar në një nocion më të gjerë të qëndrueshmërisë).

Përshkrim i shkurtër:

Agjenda Lokale 21 (“qëndrueshmëri në shkallë më të vogël”) në Vienë zbatohet në nivel qyteti dhe qarku. Për momentin, 7 qarqe operojnë me zyrat e tyre të agjendës 21+. Këto zyra krijojnë kontakte të drejtpërdrejta me qytetarët dhe palët e interesit, që janë të interesuar në zhvillim të qëndrueshëm dhe mundësisht në nisjen e projektit të vet në atë zonë. Ato informojnë për zhvillimin e qëndrueshëm në qytetin e Vienës, fushat e veprimit dhe mundësitë e pjesëmarrjes në vendimmarrje dhe përfshirje aktive. Ato janë “mundësuese” të veprimit në nivel lokal. Ato bëjnë thirrje për projekte të ndryshme dhe ofrojnë përkrahje financiare e organizative. Përqendrimi kryesor i punës së tyre është ndërgjegjësimi, për kauzën e zhvillimit të qëndrueshëm si dhe për mundësinë e pjesëmarrjes aktive dhe nisjes së projekteve për qytetarët.

Grupet e synuara për ndërgjegjësim:

Organizimet dhe fushatat e ndryshme kanë në shënjestër qytetarët e të gjitha moshave dhe prejardhjeve. Thirrjet për projekt kanë në shënjestër kryesisht qytetarët meshkuj, palët e interesit dhe organizatat jofitimprurëse.

Metodat dhe mjetet:

- ▶ **“Grätzloasen”/oazat e qarqeve:** intervenimet publike për ndërgjegjësim dhe krijim të kureshtjes. Intervenimet shpeshherë synojnë të irritojnë ose të vënë në pikëpyetje shpërndarjen e hapësirave publike me qytetarët ose nga qytetarët. P.sh. vendet për parkim si hapësira rekreative, oazat e fëmijëve ose ngastra publike të kopsh-teve, orë vallëzimi në sheshet publike, ligjërata, shfaqje mode në trotuar, palestër, rrugë për lojë ose darka publike në hapësira të rrugëve, skajet e rrugëve, parqet, etj.
- ▶ Ndërgjegjësim përmes **bashkëpunimit me shkolla:** konferenca përgatitore me mësues dhe ekspertë, pasuar nga projekte zbatimi duke përfshirë nxënësit dhe hartim i përbashkët i materialeve të duhura mësimore.
- ▶ **“Shënim i agjendës”:** Shënime publike të vendeve ku janë organizuar/organizohen ose do të organizohen projekte dhe intervenime. Piktogram, thurje ose kod QR uniforme, që shpiejnë në informata të mëtejshme lidhur me sfondin dhe opsionet e aktivizimit.

5.4 Solingen (Gjermani)

“Komunë Globale e Qëndrueshme” Solingen

48

Informatat themelore

Iniciatorët: administrata e qytetit dhe këshilli i qytetit, konsulenca lokale e qëndrueshmërisë dhe zyra e Agjendës21.

Detajet e kontaktit:

koordinatorja Ariane Bischoff, strategischeplanung@solingen.de

Periudha kohore: projekti GNK nisi në vitin 2015, procesi i ndërgjegjësimit për strategjinë e qëndrueshmërisë në vitin 2017.

Akterët e përfshirë: OJQ lokale dhe kombëtare, zyra e Agjendës21, institucionet shkencore, akterët ekonomikë, qytetarët.

Përqendrimi (OZHQ-të e synuara): të gjitha 17 OZHQ-të.

Përshkrim i shkurtër:

Në vitin 2015 Solingen, si një nga 15 qytetet në provincën e Nordrhein-Westfalen, mori pjesë në pilot projektin “Komuna Globale e Qëndrueshme”, thirrur nga Ministria Gjermane e Bashkëpunimit dhe Zhvillimit Ekonomik bëri thirrje të promovohet Agjenda 2030 në nivel lokal. Përcjellur nga fushata ndërgjegjësuese, u zhvillua një strategji për zhvillim të qëndrueshëm me pjesëmarrje të popullsisë lokale. Strategjia e qëndrueshmërisë, bazuar në rezultatet e konferencave të qëndrueshmërisë, duke përfshirë treguesit e ndërlidhur me OZHQ-të dhe një grup masash lokale, u publikuan në vitin 2018.

Grupet e synuara për ndërgjegjësim:

Organizimet dhe konferencat informuese kishin në shënjestër qytetarët e rritur.


Metodat dhe mjetet:

- ▶ Dhjetëra **takime publike të rrjetëzimit** mes përfaqësuesve të komunave tjera: diskutime dhe punëtori lidhur me mundësitë praktike për veprim në nivel lokal.
- ▶ **“Konferenca të Qëndrueshmërisë”**: format i pjesëmarrjes për të komunikuar rëndësinë e Agjendës 2030 për nivelin lokal dhe për të nxitur masa potenciale. Të dhëna dhe përshkrim i procedurës nga përfaqësues të qytetit përcjellur nga grupe ndërdisiplinore duke punuar në OZHQ të caktuara me reflektim të përbashkët mbi rezultatet. Dokumentim i hollësishëm i organizimeve dhe rezultateve online.
- ▶ Zhvillim pjesëmarrës i treguesve të qëndrueshmërisë për strategjinë: të punësuarit e qytetit, politikanët, palët e interesit dhe qytetarët kanë punuar në treguesit në grupe të vogla, për ta kuptuar kompleksitetin e zhvillimit të qëndrueshëm.
- ▶ Ftesa për organizime përmes mediave sociale dhe fletushkave në të gjitha institucionet publike (shkolla, universitete, kompani, tregje etj) Organizime publike të informimit.



4

**Krijimi i
agjendës
lokale të
OZHQ-ve**



1 Integrimi i OZHQ-ve në strategjitë lokale

Ndërkohë që është e rëndësishme si hap i parë të kuptohen dhe të rritet ndërgjegjësimi për OZHQ-të, në të njëjtën kohë komunat duhet të mendojnë për hapin e ardhshëm të lokalizimit: integrimi i OZHQ-ve në strategjinë lokale. Për të mos e mbingarkuar stafin dhe partnerët me objektiva që synojnë t'i luftojnë sfidat globale të matura me qindra tregues, OZHQ-të duhet të ndahen në zona ku ndikimi është i mundshëm, ndryshimi i arritshëm dhe përmirësimi i dukshëm.

Vini re se OZHQ-të nuk kanë domosdoshmërisht nevojë për një strategji të veten. Pothuajse të gjitha komunat kanë strategji dhe plane ekzistuese, p.sh. për zhvillimin lokal, parandalimin e varfërisë ose përmirësimin e biznesit. OZHQ-të duhet të integrohen në këto agjenda tashmë ekzistuese. Hapat e mëposhtëm mund të përdoren si udhëzues drejt integritit të OZHQ-së:

Hapi 1 Përcaktimi i përgjegjësive të OZHQ-ve në komuna

Një masë e rëndësishme është nominimi dhe emërimi i një personi apo njësie organizative për të qenë përgjegjës i përgjithshëm për zbatimin e Agjendës 2030. Kjo përfshin të gjitha aktivitetet brenda ciklit të lokalizimit siç është përshkruar në kapitullin II.3. Në mënyrë ideale, ky përcaktim i përgjegjësive duhet të bëhet edhe para masave të para të ndërgjegjësimit.

Hapi 2 Shqyrtimi i strategjive ekzistuese

Strategjitë ekzistuese lokale shqyrtohen për të vlerësuar status quo-në dhe ku ka vend për OZHQ-të. Duhet t'i kushtohet vëmendje gjetjes së paqartësive ose bashkëpunimeve të mundshme, informimit për efektet ndërsektoriale dhe krijimit të lidhjeve me objektivat e përgjithshëm lokal apo edhe kombëtare. Ky hap mund të përdoret për të gjetur frymëzim dhe ide të reja për kombinimin e politikave ekzistuese me Agjendën 2030. Qëllimi i këtij ushtrimi është të krijohet transparencë dhe për të pasur një pasqyrë si bazë për veprime të ardhshme.

Hapi 3 Përcaktimi i prioriteteve komunale të OZHQ-ve

Hapi i prioritizimit identifikon objektivat që janë të rëndësishme më të madhe për kontekstin e caktuar të një komune. Kjo është një fazë thelbësore e vendimmarrjes mes administratës dhe politikës, pasi që secila komunë mund ta përcaktojë përqendrimin e saj individualisht. Grupet partnere duhet të përfshihen në këtë proces për të siguruar se nevojat e qytetarëve dhe partnerëve janë në thelb të prioritizimit. Përdorimi i mjeteve ndërvepruese në takime të tilla të grupeve partnere e përkrah këtë proces. Sygjerimet konkrete të mjeteve të tilla mund të gjinden më vonë në këtë kapitull.

Hapi 4 Përcaktimi i objektivave strategjike për zbatimin e OZHQ-ve

Pas përcaktimit të prioriteteve për objektiva të caktuar, përcaktimi i objektivave strategjike është një mënyrë ideale e lokalizimit të OZHQ-ve. Është e rëndësishme që komunat të vendosin objektiva që janë në fushëveprimin e tyre dhe që korrespondojnë me mandatin e qeverisë lokale. Prandaj, duhet të bëhet një përzgjedhje në bazë të kapacitetit dhe përgjegjësive të komunës në fjalë. Qëllimet e tilla strategjike, bazuar në OZHQ-të me përparësi, mund të jenë për shembull sigurimi i ushqyerjes më të shëndetshme për fëmijët, sigurimi i proceseve transparente dhe pjesëmarrëse buxhetore, investimi në infrastrukturë të sigurt dhe të përmirësuar e kështu me radhë. Nëse është e mundur, duhet të zbatohen instrumentet e menaxhimit të projekteve, të tilla si përcaktimi i përgjegjësive të qarta, dakordimi për një afat kohor dhe përcaktimi i objektivave të matshëm dhe realistë duke përcaktuar treguesit. Si në hapin e mëparshëm, grupet partnere duhet të përfshihen në këtë proces.

Hapi 5 Integrimi i objektivave të ndërlidhura me OZHQ-të në strategjitë dhe planet ekzistuese

Në fund, komuna duhet t'i konsolidojë strategjitë ekzistuese me objektivat strategjike të miratuara së fundi të cilat janë të lidhura me OZHQ-të. Kjo vlen për çdo plan, koncept ose mision zhvillimor brenda komunës.

Hapi 6 Komunikimi dhe monitorimi i strategjisë së re


Sikur me të gjitha proceset e planifikimit strategjik, nuk përfundon me shkruarjen e objektivave strategjike por vazhdon me komunikimin dhe shpërndarjen e tyre konstante. Disa mjete siç janë përshkruar në [kapitullin III.3](#) mund të jenë të dobishme për këtë fazë. Grupet e themeluara partnere duhet të vazhdojnë të diskutojnë për strategjitë dhe rjetet e tyre duhet të përdoren për të shpërndarë informata për t'i përkthyer ato në veprime konkrete. Kur treguesit të jenë përcaktuar, monitorimi është qenësor për të krijuar informata kthyesë dhe për të siguruar se synimet janë arritur.

Krijimi i një agjende lokale të OZHQ-ve përfshin jo vetëm integrimin e OZHQ-ve në strategjitë lokale, por duhet edhe të reflektohet në veprimet e një komune. Nënkapitujt në vijim japin një pasqyrë të mënyrës se si mund të duken veprimet e tilla.

2 Përcaktimi i veprimeve të harmonizuara me OZHQ-të

Veprimet konkrete në lidhje me arritjen e këtyre OZHQ-ve mund të merren nga komunat pothuajse menjëherë dhe pa shumë përpjekje e shfrytëzim të burimeve. Disa veprime janë vetëm zgjerime të detyrave të cilat tashmë janë duke u përmbushur nga komunat. Të tjerat kërkojnë më shumë planifikim dhe përgatitje. Lista e mëposhtme e veprimeve të grupuara sipas objektivit të përgjithshëm strategjik jep disa ide për masa konkrete. Ato përqendrohen në gjashtë OZHQ lidhur me përfshirjen sociale të Konferencës Rajonale për përfshirje sociale dhe (ri)integrimin përmes OZHQ-ve, e mbajtur në Slloveni në prill 2018¹³.

13 “Konferenca Rajonale e përfshirjes sociale dhe (ri) integritit përmes Agjendës 2030 dhe OZHQ-ve”, u mbajt më 17 dhe 18 Prill 2018 në Brdo, Slloveni duke u fokusuar në sfidat e sjelljes së Agjendës 2030 dhe Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ-të) më afër nivelit të komunitetit, dhe duke shqyrtuar hapat përpara për arritjen e përfshirjes sociale në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe më gjërë në Evropën Juglindore. Konferenca u organizua nga Rrjeti i Shoqatave të Autoriteteve Lokale në Evropën Juglindore (NALAS), me përkrahjen e projektit rajonal të GIZ-it “Të Drejtat Sociale për Grupet e Cenuara (SoRi)”, autorizuar nga Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (BMZ).



Rritja e gjithëpërfshirjes sociale përmes...

luftimit aktiv të varfërisë së fëmijëve, veçanërisht duke i përkrahur prindërit vet-ushqyes (duke kompensuar shkurtësat në të ardhurat minimale, për shembull duke ofruar mbështetje për financimin e tarifave të arsimit, trajtimit mjekësor, qirasë, pronës, programet e kohës së lirë, etj.) duke i përkrahur prindërit aktivisht në jetën e tyre familjare përmes shërbimeve të kujdesit për fëmijë, duke organizuar punëtori për prindër, etj. të kombinuara me përfitime financiare, siç janë bileta falas për pishina. Vendosija e kopshteve, qendrave të kujdesit për fëmijë dhe shkollave afër shtëpive të pleqve/qendrave të përkujdesit, për të përkrahur bashkëpunimin dhe këmbimin mes gjeneratave. Duke organizuar shërbime mobile të përkujdesjes nëpër shtëpi për të moshuarit, duke përfshirë “shujta në karroca”, shërbime të pastrimit, etj. Duke organizuar kurse për të moshuarit, të rriturit me aftësi të kufizuara të leximit

dhe shkrimit, personat me histori emigrimi dhe ata me nevoja të veçanta (kurse gjuhe, kurse kompjuteri, aftësi për përdorim të mediave (e re), etj.). Duke promovuar struktura të gjallërishtme në lagje duke i përkrahur festimet në lagje, duke ndërtuar struktura të komunitetit, etj. Duke zgjeruar rrjetin “broadband” si bazë për pjesëmarrje më të mirë të grupeve të marginalizuara në jetën sociale dhe kulturore si dhe në tregun e punës.

Sigurimi i rritjes ekonomike përmes...

- ▶ kombinimit të zhvillimit ekonomik me aspektet sociale dhe ekologjike (kriteret të cilësisë për biznese të reja, lidhjen e subvencioneve të vazhdueshme me përmirësimet në lidhje me këto kriteret).
- ▶ organizimit të turneve nëpër kompani inovatore rajonale, planifikuar nga ekipet rajonale kreative, adresimi i nxënësve, studentëve, etj.
- ▶ promovimit të bizneseve të reja inovatore, sigurimit të lokaleve për biznese dhe hapësirave bashkëpunuese për bizneset e reja ose përkrahje aktive e vendosjes së hapësirave (shpalljeve për punë) të tilla
- ▶ parandalimit ose përmbytjes së privatizimit të ndërmarrjeve komunale (shërbimet komunale, kompanitë e transportit publik)
- ▶ zgjerimit të internetit/rrjetit “broadband” si bazë për themelimin e kompanive inovatore.

- ▶ Përforcimit të turizmit vendor duke formuar rrjete të akterëve (strategji të përbashkëta të marketingut, zhvillimi i ofertave të reja).

Përkrahje e zhvillimit të qëndrueshëm dhe mundësive të barabarta përmes...

- ▶ vendosjes së artikujve në gazetën komunale për ta bërë të dukshme dhe për të promovuar projekte përfshirëse dhe pa barriera të qytetarëve dhe për t’i publikuar ofertat dhe oraret e shoqatave që ofrojnë vizita studimore për projekte të qëndrueshme shoqërore në rajon, në qytete apo shtete.
- ▶ promovimit të mundësive të njëjta (në arsim) duke organizuar “Ditën e Vajzave”, “Universitetin e Fëmijëve” dhe “Universiteti i Studentëve”.
- ▶ ofrimit të trajnimeve për parandalim të dhunës dhe vetëmbrojtje.
- ▶ përforcimit të vazhdueshëm të qasjes në ndërtesa publike dhe për të projektuar hapësira publike pa barrierë si vendtakime për të gjithë qytetarët.

Punë drejt barazië gjinore përmes...

- ▶ përmbushjes së kuotave gjinore në komitetet lokale dhe vetë bordet mbikëqyrëse të kompanive.
- ▶ kërkesës së pagesave të barabarta për punë të barabartë dhe masa zbatuese për harmonizimin e boshllëkut gjinor në paga (trajnim të mëtejshëm për më shumë gra në pozita menaxheriale, seminare për kthim në punë pas pushimit të lehonisë, mbështetje për pushimin e lehonisë, duke mundësuar edhe punë menaxheriale me gjysmë-orari).
- ▶ ofrimit të kujdesit komunal për fëmijë pa pagesë dhe të përshtatur me orët e punës javore.
- ▶ zgjatjes e kujdesit pasdite në shkolla (kryesisht në zonat rurale).

- ▶ zgatjes së modeleve të kujdesit për fëmijë gjatë festave/pushimeve (lojë pjesëmarrëse dhe mundësi për studim).
- ▶ promovimit aktiv të strehimoreve të grave, grupeve për vetë-ndihmë, klubeve.
- ▶ ngritjes së një qendre rajonale të këshillimit/person kontaktues.
- ▶ ofrimit dhe promovimit të programeve fuqizuese dhe punëtorive për të rinjtë (vajzat dhe gratë e reja me/pa histori emigrimi, LGBTIQ).

Ndërtimi i institucioneve të forta dhe përmirësimi i qeverisjes përmes...

- ▶ promovimit të “ngritjes së kapaciteteve” në administratat komunale, për ta rritur efikasitetin dhe për të zhvilluar potencial të zbatimit (zhvillim të stafit, struktura organizative).
- ▶ ofrimit të trajnimit ndërkulturor dhe ndërdisiplinor në administratë (duke rritur ndërgjegjësimin për sfidat komplekse shoqërore, ekonomike dhe mjedisore).
- ▶ krijimit të transparencës në buxhetin publik
- ▶ prezantimit të trajnimit obligativ anti-korrupsion për administratën dhe qeverinë lokale.
- ▶ zhvillimit të një marrëveshjeje për pjesëmarrje të obligueshme.
- ▶ synimit për komunikim të nivelit të ulët dhe përfshirje të të gjithë qytetarëve (gjuhë e lehtë, forma mobile dhe të decentralizuara të informimit dhe pjesëmarrjes, përfshirje proaktive).

Themelimi i partneriteteve përmes...

- ▶ zgjerimit të bashkëpunimit dhe partneritetit në nivel lokal.
- ▶ themelimit të bashkëpunimit në nivel rajonal, duke menduar edhe për qytetin dhe zonën rreth tij (“Rajon Urban”), duke përdorur rrjete kombëtare dhe ndërkombëtare komunale dhe duke mësuar nga njëri tjetri (“Diplomaci Urbane”).
- ▶ zgjerimit të bashkëpunimit zhvillimor në nivel lokal (bashkëpunim me OJQ-të, sektorin privat, akademinë, etj.).

Këto veprime janë më të përgjithshme dhe mund të zbatohen në kontekste të ndryshme. Dy shembujt e mëposhtëm tregojnë se si komunat në rajon kanë aplikuar veprime konkrete që lidhen me rrethanat e tyre. Megjithatë, ka shumë mënyra se si të përpunohen prioritetet dhe veprimet konkrete për kontekstin lokal në një proces pjesëmarrës, i cili pastaj mund të integrohet në strategjinë e zhvillimit të komunës. Nën-kapitulli i ardhshëm do të prezantojë mjetet e punëtorisë që mund të përdoren gjatë angazhimit të grupeve partnere.



Shembuj të veprimeve konkrete të ndërmarra nga komunitat në harmoni me arritjen e OZHQ-ve

Arsimim dhe informim për legjislacionin kundër trafikimit në Elbasan, Durrës dhe Korçë (Shqipëri)

Informatat themelore	Përshkrim i shkurtër:	Grupet e synuara:	Metodat dhe mjetet:
Iniciatorët: Komuna e Elbasanit, Durrësit dhe Korçës dhe Ambasada e SHBA-ve në Tiranë	<p>Aktivitetet e ndërgjegjësimit dhe informimit janë thelbësore për të rritur njohuritë e grupeve të cenuara të prekura nga trafikimi njerëzor. Duke ofruar një seri seancash edukative me komitetet rajonale kundër trafikimit (KRKT), studentët e universiteteve, prindërit, viktimat e trafikimit që Elbasani, Korça dhe Durrësi të bëhen më të vetëdijshme për të drejtat e tyre lidhur me këtë çështje.</p>	<p>Përfitues të projektit do të jenë të miturit si viktimat e trafikimit, prindërit e tyre, anëtarët e KRKT, më shumë se 1000 studentë të fakulteteve juridike të 3 universiteteve shtetërore, Komuna e Elbasanit, Korçës dhe Durrësit.</p>	<ul style="list-style-type: none">▶ Mbatja e <u>seancave informuese</u> për studentët e fakultetit juridik në Elbasan; Korçë; Universitetin e Durrësit për legjislacionin e ndryshuar kundër trafikimit. <u>Forumet e diskutimit</u> do të organizohen edhe me studentët nga Fakulteti Juridik në Universitetet Shtetërore të Elbasanit, Durrësit dhe Korçës. Rreth 500 studentë do të marrin pjesë në këto forume të hapura. Ekspertët e fushës do të prezantojnë temën dhe do t'u përgjigjen pyetjeve.▶ Prezantimi dhe shpërndarja e <u>materialëve të ndërgjegjësimit</u> do të jetë pjesë e të gjitha seancave të edukimit, të cilat do të udhëhiqen nga ekspertët e sektorit të drejtësisë, si prokurorët, avokatët, si dhe punëtorët social.▶ Organizimi i <u>seancave informuese për viktimat e trafikimit dhe prindërit e tyre</u> që janë aktualisht në programet e mbrojtjes. Seancat informuese do të zhvillohen edhe për viktimat e trafikimit të përfshira aktualisht në programet mbrojtëse të strehimoreve si dhe në qendrat ditore të drejtuara nga OJQ të tjera në rajonin e Elbasanit.▶ <u>Debate në televizionin lokal</u> për të informuar qytetarët për ndryshimet ligjore në lidhje me trafikimin. Mediat lokale të Elbasanit do të përdoren për të shpërndarë informacione për të drejtat ligjore / ndryshimet e viktimave të trafikimit për një audiencë më të gjerë.▶ <u>Prezantimi në media sociale</u> i të gjitha aktiviteteve
Detajet e kontaktit: Ardiana Kasa (dkasa@hotmail.com)	<p>Forume diskutimi do të përqendrohen në ndryshimet e reja legjislative mbi trafikimin, duke marrë parasysh se institucionet shtetërore kundër trafikimit, të rinjtë dhe viktimat e trafikimit nuk kanë informata për ndryshimet në kornizën ligjore kundër trafikimit. Prandaj forumet e diskutimit do të përqendrohen në ligjet e reja të miratuara dhe ndryshimet e reja nën shqyrtim.</p>		
Periudha kohore: nëntor 2018- maj 2019			
Akterët e përfshirë: Organizatave shoqërisë civile, komitetet rajonale kundër trafikimit, grupet e cenuara, familjet e viktimave, studentët e universiteteve			
Përqendrimi (OZHQ-të e synuara): OZHQ-të 5, 8, 16 and 17			

Fushata e vaksinimit në Berat (Shqipëri)

Informata themelore

Iniciatorët:

Partnere për Fëmijët, Qendra Komunitare e Komunës së Beratit

Detajet e kontaktit:

Ingrid Jones,
Alda Kondakciu,
Adelajda Cabej

Periudha kohore:

Janar 2019

Akterët e

përfshirë: Ofruesit e shërbimeve shëndetësore, Qendra Komunitare Interkulturore në Berat

Përqendrimi

(OZHQ-të e synuara): OZHQ 3 “Sigurimi i jetës së shëndetshme dhe promovimi i mirëqenies për të gjithë dhe në çdo moshë” / Synimi 3.8

Përshkrim i shkurtër:

Ofruesit e shërbimeve shëndetësore së bashku me stafin e Qendrës Komunitare Ndërkulturore të Komunës mbajnë aktivitete ndërgjegjësimi dhe informimi për komunitetin rom në komunën e Beratit.

Qëllimi i këtij aksioni ishte të theksonte rëndësinë e vaksinimeve për fëmijët. Pas kësaj fushate, janë vaksinuar 25 fëmijë nga komuniteti rom.

Grupet e synuara:


Prindërit rom.

Metodat dhe mjetet:

- ▶ Seanca informuese në komunitet
- ▶ Takime një-me-një

3 Mjetet e punëtorive për grupet partnere

OZHQ Lab - pse OZHQ-të kanë rëndësi në kontekstin tim lokal?



58

Kategoria e mjetit:	Punëtori
Kohëzgjatja:	2 orë
Pjesëmarrësit e mundshëm:	nëpunësit civilë, administratorët publikë, politikanët lokalë, bizneset lokale, OJQ-të dhe çdo partner tjetër relevant
Materiali i nevojshëm:	materialet e printuara të qëllimeve dhe objektivave, letër flipchart, stilolapsa
Objektivi/rezultatet:	Mbledhja e veprimeve konkrete dhe të rekomanduara
Zhvilluar nga:	Qendra KDZ për Hulumtime të Administratës Publike

Procedura:

Të gjithë pjesëmarrësit duhet të ndahen në grupe të vogla dhe t'u caktohen OZHQ të ndryshme. Atyre u jepen materialet e punëtorisë siç është dokumenti me një faqe që shpjegon secilën OZHQ dhe objektivat e tyre përkatëse për qeveritë lokale, si dhe letër flipchart dhe stilolapsa. Detyra e tyre është të vlerësojnë dhe diskutojnë pyetjen e mëposhtme në grupe të vogla:

” Çfarë veprimesh mund të ndër marrë komuna ime për ta mbështetur këtë OZHQ?

Pasi grupet e vogla të kenë diskutuar dhe shkruar gjetjet e tyre, secili grup do të japë një prezantim të vogël me ndihmën e një flipchart-it mbi përgjigjet që kanë dhënë. Një dialog midis grupeve duhet të inkurajohet për të gjetur ndërlidhje midis OZHQ-ve më relevante për nivelin lokal. Nëse ka kohë, mund të nisë një diskutim rreth çështjes se si një qasje e integruar mund të zbatohet në qytet ose në komunë.

SDG 01 — END POVERTY IN ALL ITS FORMS EVERYWHERE.

This goal is about raising the incomes of the poorest, but it's also about ensuring access to basic services, and protecting everyone from human-caused and natural disasters



What activities can my municipality implement to reach this goal?

Empty box for writing activities.

Relevant targets for local governments

- 1.1** by 2030, eradicate extreme poverty for all people everywhere, currently measured as people living on less than \$1.25 a day
- 1.2** by 2030, reduce at least by half the proportion of men, women and children of all ages living in poverty in all its dimensions according to national definitions
- 1.3** Implement nationally appropriate social protection systems and measures for all, including floors, and by 2030 achieve substantial coverage of the poor and the vulnerable
- 1.4** by 2030 ensure that all men and women, particularly the poor and the vulnerable, have equal rights to economic resources, as well as access to basic services, ownership, and control over land and other forms of property, inheritance, natural resources, appropriate new technology, and financial services including microfinance
- 1.5** by 2030 build the resilience of the poor and those in vulnerable situations, and reduce their exposure and vulnerability to climate-related extreme events and other economic, social and environmental shocks and disasters

Burimi: KDZ 2018



Burimi: KDZ 2018

Vetëvlerësimi i OZHQ-ve - renditja e OZHQ-ve përkatëse për kontekstin lokal komunal



60

Kategoria e mjetit:	Punëtori
Kohëzgjatja:	2 orë
Pjesëmarrësit e mundshëm:	nëpunësit civilë, administratorët publikë, politikanët lokalë dhe çdo partner tjetër relevant
Materiali i nevojshëm:	tabela e OZHQ-ve relevante për kontekstin lokal (të gjitha OZHQ-të ose përzgjedhja e OZHQ-ve), diagrami rrotullues me OZHQ-të relevante, lapsa
Objektivi/rezultatet:	Analiza e status quo-s lokale si bazë për veprime konkrete
Zhvilluar nga:	Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ)

Procedura:

Në hapin e parë, të gjithë pjesëmarrësit njihen me OZHQ-të. Nëse janë përzgjedhur vetëm OZHQ të veçanta, arsyet për këtë përzgjedhje duhet të shpjegohen.

Pjesëmarrësve u kërkohet pastaj të rangojnë në mënyrë cilësore qytetin e tyre në lidhje me secilin nga objektivat e listuara. Pikët mund të plotësohen në tabelë ose të ilustrohen në një diagram rrotullues me të njëjtën përmbajtje si tabela (një shembull është paraqitur më poshtë).

Gjatësia ndërmjet qendrës së rrethit dhe qëllimit specifik përfaqëson nivelin e arritjes së atij objekti të caktuar. Unazat e brendshme përfaqësojnë kategoritë cilësore, p.sh. unaza 1 (unazë e brendshme): kritike, unaza 2: shumë e pakënaqshme, unaza 3: themelore, unazë 4: e kënaqshme, unazë 5: e mirë, unaza 6 (unaza e jashtme): e jashtëzakonshme. Ushtrimi mund të thjeshtësohet ose të bëhet më kompleks, në varësi të kërkesave dhe kapaciteteve lokale.

Analiza të mëtejshme mund të bëhet duke diskutuar pyetje të tilla si:


” Si ndihemi kur i analizojmë këto objektiva?

Cilat janë arsyet për renditjet e këqija? Cilat janë arsyet për renditjet e mira?

Çfarë mund të bëhet për të përmirësuar kategoritë e këqija?

Diskutimi duhet të dokumentohet si bazë për identifikimin e lidhjeve dhe nxjerrjen e veprimeve konkrete.

61



Mjeti interaktiv i KB



62

Kategoria e mjetit:	Punëtori
Kohëzgjatja:	2-3 orë
Pjesëmarrësit e mundshëm:	nëpunësit civilë, administratorët publikë, politikanët lokalë si dhe grupet partnere me përfaqësues të OJQ-ve, sektorit privat dhe mediat
Materiali i nevojshëm:	1 grup i mjeteve interaktive / për një grup prej maks. 6 pjesëmarrësish
Objektivi/rezultatet:	Identifikimi i OZHQ dhe objektivit përkatës për nivelin lokal, aktivitetet konkrete dhe veprimet e rekomanduara
Zhvilluar nga:	Kombet e Bashkuara në Bosnjë dhe Hercegovinë

Procedura:

Të gjithë pjesëmarrësit ndahen në grupe prej 6 anëtarësh. Çdo grup duhet të koordinojë 1 OZHQ (nga gjithsej 17) që do të adresohet gjatë punëtorisë, si dhe objektivin përkatës - të gjithë anëtarët e grupit votojnë dhe pajtohen me konsensus për **një qëllim** dhe **një objektiv**.

Përmes zgjedhjes dhe vendosjes së kartave vlerësuese, kartave të veprimit, kartave të elementeve të sistemit / mekanizmave dhe

kartave të sfidave / mundësive / barrierave, pjesëmarrësit propozojnë zgjidhje dhe rrugë përmes dialogut dhe konsensusit. Në fund, secili grup paraqet gjetjet e tyre dhe mënyrën më të mirë se si të arrihet objektivi i përzgjedhur i OZHQ në nivel lokal.

Për më shumë informata dhe një udhëzues praktik për këtë mjet, i referohemi shtojcës.



Navigatori OZHQ



64

Kategoria e mjetit:	Bashkë-krijimi i mjeteve të individualizuara të informimit
Kohëzgjatja:	disa javë, varësisht nga shpeshtësia e takimeve
Pjesëmarrësit e mundshëm:	Grupet e krijuara partnere
Materiali i nevojshëm:	ndoshta dizajner grafik (për rezultatin përfundimtar)
Objektivi/rezultatet:	Mbledhja e veprimeve konkrete dhe të rekomanduara dhe krijimi i mjeteve për shkëmbimin e informacionit
Zhvilluar nga:	Shoqata Austriake e Qyteteve dhe Qytezave (AACT)

Procedura:

Një grup partner me përfaqësues nga sektorë të ndryshëm mbledhet rregullisht për të përcaktuar masat dhe veprimet relevante që komunat duhet të ndërmarrin për të arritur OZHQ të ndryshme. Kategoritë mund të përcaktohen individualisht. Për shembull, mund të ketë kategori të tilla si shërbimet publike, planifikimi hapësinor, arsimi dhe ekonomia, mirëqenia sociale dhe shëndeti e qeverisja. Bazuar në këto kategori, duhet të ketë sugjerime konkrete për veprime nga komunat në secilën kategori. Pas hartimit të këtyre veprimeve, OZHQ-ve të ndryshme mund t'u caktohen masa të ndryshme. Është e dëshirueshme që të ketë një diskutim, dialog dhe shkëmbim të vazhdueshëm.

Sapo këto të përcaktohen gjatë seancave të rregullta, mund të krijohet një mjet në formën e një „Navigatori OZHQ“. Kjo është në formën e një table fizike rrotulluese nga kartoni, ku përdoruesit mund të shohin masa të ndryshme dhe të shohin se cilat OZHQ preken duke kthyer tabelën dhe duke zbuluar kuti të ndryshme. Ky mjet fizik mund të shpërndalet në organizime, shkolla, OJQ dhe ngjarje tjera.



4 Shembuj nga Ballkani Perëndimor

4.1 Bijelinë (Bosnjë dhe Hercegovinë)

Rishikimi i Strategjisë së Zhvillimit të Integruar të Qytetit të Bijelinës (2019-2023)

66

Informata themelore

Iniciatorët: Qyteti i Bijelinës, Shkurt 2018

Detajet e kontaktit: Ankica Todorović (ankica.todorovic@gradbijeljina.org) dhe Mile Pejčić (mile.pejdic@gradbijeljina.org)

Periudha kohore: Publikuar për herë të parë në 2014, rishikuar në 2018

Akterët e përfshirë: Të gjitha departamentet e qytetit të Bijelinës, grupet partnere të qytetit - përfaqësues të sektorit publik, privat dhe civil

Përqendrimi (OZHQ-të e synuara): Të gjitha 17 OZHQ-të janë analizuar, fokusi i vendosur në 10 OZHQ.

Mënyra e integritit të OZHQ: Rishikimi i strategjisë ekzistuese

Përshkrim i shkurtër i procesit:

Qyteti i Bijelinës krijoi Strategjinë e Zhvillimit të Integruar në vitin 2014 për periudhën 2014-2023. Pas 5 viteve të zbatimit, u zhvillua një vlerësim i jashtëm i cili rekomandoi një rishikim të dokumentit, pasi shumica e projekteve të planifikuara u zbatuan ose u kapërcyen. Kjo u konsiderua nga Administrata e Qytetit si një mundësi e mirë për të përfshirë Agjendën 2030 në politikat kryesore lokale duke marrë parasysh rrethanat e tyre lokale. Me nismën e qytetit, një vlerësim për planifikimin e përafrimit të Strategjisë së Zhvillimit të Integruar të Bijeljinës (2014-2023) me OZHQ-të u zhvillua nga ekspertët e OKB-së, duke përcaktuar si më poshtë: nga 17 OZHQ, 10 ishin adresuar pjesërisht në periudhën strategjike 2014- 2018 dhe nga 169 synime OZHQ, u adresuan 33.

Rishikimi i Strategjisë së Zhvillimit të Qytetit të Bijeljinës për periudhën 2019-2023 filloi në maj 2018 dhe hapi rrugë për integrimin e duhur të OZHQ-ve. Ajo u bë me **3 hapa për integrimin e OZHQ-ve:**

- ▶ **Rishikimi i strategjisë së vlefshme dhe identifikimi i fushave për ndryshim:** Të gjitha qëllimet strategjike janë relevante për OZHQ-të, gjegjësisht mbulojnë temat e adresuara nga OZHQ-të
- ▶ **Përcaktimi i objektivave përkatëse:** Gjatë rishikimit të strategjisë në vazhdim, Ekipi i Zhvillimit të Qytetit ka integruar synimet e përshtatura të OZHQ në qëllimet strategjike të Bijelinës



Përshkrimi

- ▶ **Rregullimi i treguesve global:** Treguesit relevantë globalë u përshtatën dhe përfshinë në strategji
- ▶ **Formulimi i strategjisë së re dhe planit të zbatimit për 1 + 2 vjet duke përdorur qasjen e sistemeve të integruara:** Rekomandimet dhe njohuritë nga vlerësimi i strategjisë janë inkorporuar në strategjinë dhe planin e zbatimit, në mënyrë që të sigurohet që qëllimet dhe angazhimet të jenë të realizueshme, dhe të përshtatshme me burimet dhe kapacitetet e zbatimit.

Ndërgjegjësimi

Aktivitetet për rritjen e ndërgjegjësimit u zhvilluan përmes një qasjeje transparente dhe gjithëpërfshirëse, e cila përfshinte përfaqësues të jashtëm dhe të brendshëm të sektorëve të ndryshëm, përmes grupeve të fokusuara të organizuara dhe takimeve të rregullta të ekipit të Zhvillimit të Qytetit gjatë procesit të rishikimit të Strategjisë së Zhvillimit.

Rezultati/Aktivitetet përcjellëse:

Zbatimi i projekteve strategjike pas miratimit të saj nga asambleja e qytetit.

4.2 Elbasan, Librazhd dhe Kukës (Shqipëri)

Monitorimi i shpërndarjes së barabartë të të drejtave sociale për grupet e rrezikuara në nivel kombëtar dhe lokal

Informata themelore

Iniciatorët: Qendra ALTRI

Detajet e kontaktit: Eda Noçka –
qendra.altri@gmail.com

Periudha kohore: Dhjetor 2018 –
Korrik 2019

Akterët e përfshirë: Qeveritë lokale të Kukësit, Librazhdit dhe Elbasanit; Avokati i Popullit; Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Përqendrimi (OZHQ-të e synuara): Të gjitha 17 OZHQ-të, veçanërisht ato që lidhen me grupet e cenushme

Mënyra e integritimit të OZHQ: identifikimi, mbledhja e të dhënave dhe publikimi i rezultateve të niveleve të ndërgjegjësimit për OZHQ-të dhe strategjitë që lidhen me OZHQ-të si bazë për vendosjen e veprimeve konkrete

Përshkrim i shkurtër i procesit:

- ▶ **Vlerësim** i cili fokusohet në pikat në vijim:
 - (i) Vlerësoni njohuritë e komunave lidhur me Agjendën 2030
 - (ii) Vlerësoni përfshirjen e OZHQ-ve në planet e tyre strategjike dhe të veprimit
 - (iii) Vlerësoni masat e marra dhe mjetet e përdorura për arritjen e tyre dhe treguesit për matjen e tyre
 - (iv) Identifikoni qëllimet specifike që do të jenë në fokus të këtij projekti.
- ▶ Organizimi i **seminareve** me përfaqësues nga Avokati i Popullit dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe me përfaqësues nga komunat.
- ▶ Zhvillimi i **vizitës studimore** në Kosovë për të ndarë përvojën dhe njohuritë lidhur me OZHQ-të dhe mbi rolin e institucioneve në zbatimin e OZHQ-ve dhe të drejtave sociale në nivel lokal.
- ▶ Lëshimi i **raportit përfundimtar** i cili do të përfshijë të dhënat e mbledhura gjatë zhvillimit të projektit, përfundimet dhe rekomandimet.

Ndërgjegjësimi

Përmes këtij projekti, qëllimi është forcimi i kapaciteteve monitoruese të Institucionit të Avokatit të Popullit ndaj njësive të qeverisjes lokale në zbatimin e të drejtave sociale të grupeve të rrezikuara. Projekti gjithashtu synon të rrisë ndërgjegjësimin dhe informimin e institucioneve dhe grupeve të rrezikuara mbi të drejtat sociale që gëzojnë këto të fundit.

Rezultati/Aktivitetet përcjellëse:

Përdorimi i rezultateve nga raporti përfundimtar për të vendosur veprime konkrete

5 Shembuj ndërkombëtarë

5.1 Vjenë (Austri)

Strategjia Kornizë e Qytetit të Mençur të Vjenës

70

Informata themelore

Iniciatorët: Qyteti i Vjenës, MA 18, MA 22

Detajet e kontaktit: Koordinatori për Qëndrueshmëri Thomas Hruschka, thomas.hruschka@wien.gv.at

Periudha kohore: publikuar për herë të parë në vitin 2014, rishikuar më 2018-2019

Akterët e përfshirë: Të gjitha departamentet e qytetit (MA) të Vjenës.

Përqendrimi (OZHQ-të e synuara): Të gjitha 17 OZHQ-të do të analizohen dhe integrohen.

Mënyra e integritit të OZHQ: rishikimi i strategjisë ekzistuese

Përshkrim i shkurtër i procesit:

Në vitin 2017, Viena vendosi për rishikimin e Strategjisë Kornizë të Qytetit të Mençur të Vjenës (SCRS) me integrimin e drejtpërdrejtë të OZHQ-ve. Një matricë me të gjitha qëllimet e SCRS ekzistuese dhe OZHQ-ve u zhvillua dhe gradualisht, shkalla e mbulimit u përcaktua. OZHQ-të ofrojnë një vështrim më të ndërlidhur në detyrat komunale dhe ndihmojnë në kapërcimin e strukturës së ngurtë të departamenteve të qytetit të ndara në mënyrë tematike për të mbështetur agjendën gjithëpërfshirëse të Qytetit të Mençur. Bazuar në këtë analizë, grupet tematike të punës me anëtarët e departamenteve të ndryshme të qytetit po punojnë në strukturën dhe përmbajtjen e SCRS së re. Miratimi zyrtar në këshillin e qytetit si përfundim i procesit është planifikuar për periudhën mes 2019-ës.

Ndërgjegjësimi

- ▶ Rritja e ndërgjegjësimit për OZHQ-të u përqëndrua kryesisht tek *punonjësit e departamenteve të ndryshme të qytetit të Vjenës*. Për të optimizuar punën e ekipeve ndërdisiplinore dhe të departamentit për një afat të gjatë, secili anëtar i grupit dhe përfaqësuesi i departamentit duhej të merrej me rëndësinë e OZHQ-ve për fushën e tyre tematike dhe të qytetit të Vjenës.
- ▶ Në një „ditë të hapur“ në fund të tetorit, publiku u ftua të jepte reagime mbi procesin e Qytetit të Mëcur me anë të një pyetësi, si dhe të shprehte lirshëm shqetësimet, dëshirat ose pyetjet e hapura. Aktivitete të ndryshme për të gjitha *grupmoshat* përfshinin diskutime, rrota të fatit, kuize, turne biçikletash virtuale etj.

Rezultati/Aktivitetet përcjellëse:

Procesi nuk ka përfunduar, nuk janë shpallur ngjarje të tjera publike.

5.2 Hanover (Gjermani)

Strategjia e Zhvillimit të Qytetit të Hanoverit 2030

Informata themelore

Iniciatorët: administrata e qytetit dhe këshilli i qytetit, konsulenca lokale e qëndrueshmërisë dhe zyra Agjenda21.

Detajet e kontaktit: 2030@Hannover-Stadt.de, www.hannover.de

Periudha kohore: procesi i rishikimit filloi në vitin 2014, strategjia u publikua në vitin 2016.

Akterët e përfshirë: OJQ lokale dhe kombëtare, institucione arsimore dhe shkencore, akterë ekonomikë, banorë.

Përqendrimi (OZHQ-të e synuara): Fushat e veprimit në strategji synojnë tematikisht OZHQ-të 4,6,8,9,11,12,13,14,15 dhe 16, me fokus në OZHQ-të 11 dhe 15.

Mënyra e integrit të OZHQ: rishikimi i strategjisë ekzistuese të zhvillimit të qytetit

Përshkrim i shkurtër i procesit:

Procesi i pjesëmarrjes së rishikimit filloi në vitin 2014 me „Dialogun e Qytetit“. Përmes një fushate të gjerë mediatike, banorët u ftuan për t'iu bashkuar procesit. Procesi i suksesshëm mund të përfshinte rreth 25.000 qytetarë.

Ndërgjegjësimi

- ▶ Ndërgjegjësimi për fillimin e procesit u ngrit përmes mediave të ndryshme: faqe të internetit, fletëpalosje, posterë në stacionet e transportit publik, ftesa direkte, ftesa me video nga kryetari i komunës, gazeta e qytetit me njoftime, ngjarje dhe përditësime. *5 zëdhënës lokalë* u përzgjedhën për të përfaqësuar fushatën drejtuar banorëve të të gjitha moshave dhe prejardhjeve (shumica e ngjarjeve shënjestronin të rriturit).
- ▶ „Dialogu i qytetit“: Procesi pjesëmarrës u iniciua me prezantime dhe diskutime publike, 200 ngjarje të ndryshme pasuan, p.sh. shëtitjet me ciceron nëpër qytet, diskutime në „shtëpitë e kafesë“, ekspozita. Paneli përfaqësues i qytetarëve u krijua për të dhënë reagime në lidhje me vetë procesin e pjesëmarrjes. Të gjitha rezultatet u dokumentuan dhe u rishikuan në një punëtori nga një *grup ndërdisiplinor* prej 90 vetësh, përfshirë këshillin e qytetit dhe anëtarët e administratës, palët e interesit, ekspertët dhe qytetarët. Rekomandimet e tyre pastaj u zhvilluan në masa specifike dhe në dokumentin final të strategjisë nga administrata e qytetit. I gjithë procesi është dokumentuar në mënyrë të përpiktë në internet dhe në shtyp.

Rezultati/Aktivitetet përcjellëse:

- ▶ Aktualisht, janë duke u zbatuar rreth 40 masa të përcaktuara në strategjinë e zhvillimit të qytetit të Hanoverit 2030.
- ▶ Mjeti monitories për veprim lokal i „Strategjisë së Qëndrueshmërisë së Hannoverit 2018“ sistematikisht zbërthen OZHQ-të në fushat lokale të veprimit dhe departamentet përgjegjëse komunale. Krijuar në përpjekje të përbashkëta për të rritur ndërgjegjësimin midis punonjësve të administratës së qytetit.

5.3 Ludvigsburg (Gjermani)

Strategjia e Zhvillimit të Qytetit të Ludwigsburg-ut

Informata themelore

Iniciatorët: administrata e qytetit dhe këshilli i qytetit, departamenti i zhvillimit të qëndrueshëm.

Detajet e kontaktit: koordinatori Albert Geier, stadtentwicklung@ludwigsburg.de, <https://2030.meinlb.de/zukunftskonferenz/>

Periudha kohore: strategjia u publikua së pari në vitin 2006, e përshtatur çdo 3 vjet, rishikimi i fundit është aktualisht në proces.

Akterët e përfshirë: OJQ lokale dhe kombëtare, institucionet arsimore dhe shkencore, akterët ekonomikë, qytetarët

Përqendrimi (OZHQ-të e synuara):Të gjitha 17 OZHQ-të do të analizohen dhe integrohen.

Mënyra e integrimit të OZHQ: rishikimi i strategjisë ekzistuese të zhvillimit

Përshkrim i shkurtër i procesit:

Për të koordinuar zhvillimin e qëndrueshëm midis departamenteve të ndryshme dhe palëve të interesit në qytetin e Ludwigsburg-ut, qyteti ka krijuar departamentin ndër-sektorial për zhvillimin e qëndrueshëm. Departamenti organizon „Konferenca të së Ardhmes“ çdo tre vjet, në bazë të së cilës rishikohet strategjia e zhvillimit të qytetit. Në qershor të vitit 2018, u zhvillua së fundi “Konferenca e së ardhmes”.



Ndërgjegjësimi

- ▶ *Konferencat e së ardhmes*: Mbahen ngjashëm me punëtoritë, gjatë 2 ditëve. Të dhëna hyrëse (inpute) nga përfaqësuesit e qytetit, punë në grupe ndërdisiplinore. Diskutim jo-hierarkik midis qytetarëve, politikanëve dhe ekspertëve. Rezultoi në një mbledhje të ideve dhe propozimeve rreth integritit të OZHQ-ve në planet e mëdha të qytetit, dhe drafte për një grup treguesish dhe masash specifike. Dokumentacioni i detajuar i procesit dhe rezultateve u vendos në internet.
- ▶ *KSIS: Sistemi i informacionit online* ka filluar në vitin 2016, lidhje transparente e të dhënave komunale, plane të mëdha dhe raporte të progresit të projekteve dhe masave. Mjet gjithëpërfshirës informacioni online për zhvillimin lokal dhe veprimet për qytetarët.
- ▶ „*One-World-Forum*“: Rrjet i akterëve nga institucionet arsimore, shoqatat, përfaqësuesit e emigrantëve dhe iniciativat për nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm global. Inicimi i projekteve globale të partnerëve, ngjarjeve dhe fushatave të ndërgjegjësimit përmes palëve jo-zyrtare, por të mbështetura nga komuna.

Rezultati/Aktivitetet përcjellëse:

Rezultatet e “konferencës së fundit të së ardhmes” po përpunohen nga grupi drejtues dhe ekspertët.

5.5 Portali i OZHQ-ve (Gjermani)

Portali online për treguesit e OZHQ-ve

76

Informata themelore

Iniciatorët: fondacioni jofitimprurës, institucionet kërkimore federale dhe private, asociacioni i qyteteve gjermane, asociacioni gjerman i qyteteve dhe komunave, agjencia qendrore e kontaktit për iniciativat e politikave zhvillimore

Detajet e kontaktit: <https://OZhQ-portal.de/>

Periudha kohore: 2017-2020

Akterët e përfshirë: komunat, OJQ-të lokale dhe kombëtare

Përqendrimi (OZHQ-të e synuara):Të 17 OZHQ-të mbulohen nga treguesit.

Mënyra e integritit të OZHQ: identifikimi, mbledhja e të dhënave dhe publikimi i rezultateve të treguesve të lidhur me OZHQ si bazë për identifikimin e nevojave lokale për veprim për arritjen e OZHQ / bazës për zhvillimin e strategjisë.

Përshkrim i shkurtër i procesit:

Fondacioni Bertelsmann, Instituti Federal për Kërkime mbi Ndërtimin, Çështjet Urbane dhe Zhvillimin Hapësinor, Shoqata e Qyteteve Gjermane dhe agjencia qendrore e kontaktit për iniciativat e politikave zhvillimore „Engagement Global“ filloi procesin për hartimin e treguesve për zhvillim të qëndrueshëm në nivel lokal në komunat gjermane dhe për t’u ofruar të dhëna komunave dhe publikut. Procesi i përbashkët kishte këta hapa:

1. Rëndësia - Kontrolli i nën-objektivave për komunat gjermane - përqendrohet në rëndësinë për detyrat publike.
2. Identifikimi dhe përshkrimi i treguesve - përqendrohet në aplikueshmërinë dhe disponueshmërinë e të dhënave reale.
3. Mbledhja dhe analiza e të dhënave nga komunat.
4. Sigurimi, analiza dhe paraqitja e rezultateve.

Ndërgjegjësimi

- ▶ Diskutime me partnerët e projektit, përfaqësuesit e komunave gjermane dhe ekspertët mbi rezultatet e përkohshme të procesit.
- ▶ **Faqja e internetit e OZHQ-së** shfaqë rezultatet e treguesve të OZHQ-ve për të gjitha komunat gjermane pjesëmarrëse për pesë vitet e fundit dhe lejon monitorimin dhe krahasimin e drejtpërdrejtë të komunave të ndryshme. Synon të mbështesë komunat me identifikimin e nevojave të tyre për veprim në nivel lokal duke dhënë një pasqyrë të statusit të tyre të tanishëm në rrugën drejt arritjes së OZHQ-ve. E lidhur direkt me wegweiser-kommune.de, një **sistem informacioni online** me grupe të të dhënave gjithëpërfshirëse komunale.
- ▶ Për më tepër, ajo shërben si një platformë kontekstuale për rezultatet, e cila siguron informata lehtësisht të arritshme për publikun dhe siguron një mjet të dobishëm për punën e vazhdueshme të ekspertëve / përfaqësuesve të komunës. Fatkeqësisht vetëm në gjuhën gjermane.
- ▶ **Publikimi** „Treguesit e OZHQ-ve për komunat“ përmban qasjen metodologjike dhe të gjithë treguesit e zhvilluar. Mundëson punën e vazhdueshme të ekspertëve / përfaqësuesve të komunës.

Rezultati/Aktivitetet përcjellëse:

Grupi i treguesve dhe ndërfaqja lehtë e qasshme online mbështesin avancimin e zhvillimit të qëndrueshëm në të gjitha komunat gjermane.

5.5 Sharnstein (Austri)

Agjenda Lokale 21 Sharnstein – “Zukunftprofil 2025”

Informata themelore

Iniciatorët: administrata dhe këshilli komunal.

Detajet e kontaktit: Menaxhmenti Rajonal: Johannes Meinhart, johannes.meinhart@rmooe.at

Periudha kohore: inicimi i procesit për zhvillimin e strategjisë në vitin 2014

Akterët e përfshirë: akterët lokal ekonomikë, ekspertët, qytetarët.

Përqendrimi (OZHQ-të e synuara): nuk ka lidhje të qartë me OZHQ-të, fokusi tematik në OZHQ-të 8 dhe 15.

Mënyra e integrit të OZHQ: zhvillimi i strategjisë së re.

Përshkrim i shkurtër i procesit:

Komuna e vogël rurale e Sharnstein filloi një proces për krijimin e strategjisë së zhvillimit „Zukunftprofil 2025“ (profili për të ardhmen) në vitin 2014.

Ndërgjegjësimi

- ▶ „Zukunftsdialoge“ / *Dialogjet e së ardhmes*: Organizohen ngjashëm me punëtorinë, të dhëna hyrëse (input) nga përfaqësuesit e komunës, punë në grupe ndërdisiplinore. Diskutim jo-hierarkik midis qytetarëve, politikanëve dhe ekspertëve. Gjatë 4 dialogjeve, propozimet dhe idetë për strategjinë u grumbulluan dhe u zhvilluan nga një grup përfaqësuesish zyrtarë, ekspertësh dhe 17 qytetarësh të zgjedhur në mënyrë të rastësishme, duke integruar në mënyrë specifike grupet shoqërore të vështira për t'u arritur (të moshuar, emigrantë, të rinj). Ky grup krijoi një draft për strategjinë, e cila u diskutua më pas nga 100 qytetarë të tjerë. U krijuan 5 grupe për fushat e përcaktuara kryesore lokale të veprimit (p.sh. bujqësia, mbrojtja e peizazheve natyrore dhe krijimi i vlerave rajonale). Për çdo temë, u organizua një „forum“ publik për të themeluar projekte implementimi dhe grupe përgjegjëse.
- ▶ Themelimi i „*Këshillit të Qytetarëve*“ që vlerëson projektet çdo vit dhe përpunon propozimet për vitin vijues. Gjithashtu funksionon si një ndërfaqe, përmes së cilës qytetarët e tjerë të interesuar mund t'i bashkohen procesit.
- ▶ Ftesë për ngjarjet informuese dhe dialogjet e së ardhmes përmes postës, internetit dhe zyrave komunale.

Rezultati/Aktivitetet përcjellëse:

Është shpallur në vitin 2018, se komuna do të krijojë një zyrë lokale të Agjendës 21 në janar të vitit 2019, në mënyrë që të ndërtohet mbi aktivitetet e suksesshme drejt zhvillimit të qëndrueshëm dhe të përdorë strukturat e mirëfillta për pjesëmarrjen e qytetarëve.



5

**Roli i SHQL-
ve dhe
NALAS-
ve në
mobilizimin
e komunave
për arritjen
e OZHQ-ve**

1 Udruženja lokalnih samouprava

Ka arsye të ndryshme pse qeveritë lokale nuk janë të motivuara për të marrë pjesë në arritjen e OZHQ-ve: ndoshta ata nuk kanë informacion rreth Agjendës 2030, burime për të mbajtur fushata ose thjesht mendojnë se janë tepër të vogla për të bërë dallimin. Megjithatë, kjo nuk është arsye për pasivitet. Kjo krijon një hapësirë që duhet të plotësohet nga Shoqatat e Qeverisjes Lokale (SHQL). Për shkak të pozitës së tyre unike në çdo vend, SHQL-të duhet të udhëheqin procesin e ngritjes së vetëdijes në mesin e anëtarëve të tyre. Nuk ka njësi më mirë të pozicionuar për të bindur qeveritë lokale se çdo nivel i qeverisjes ka rolin e vet në proces, pavarësisht nga madhësia apo kapaciteti.

Duke u mbështetur në këtë, SHQL-të duhet të ofrojnë informacion dhe njohuri për nivelet nën-kombëtare të qeverisjes dhe duhet të qartësojnë rolin

e tyre në zbatimin e OZHQ-ve dhe në hartimin e strategjive kombëtare dhe nën-kombëtare. Duke vepruar kështu, SHQL-të do të inkurajojnë anëtarët e tyre që të shohin procesin e arritjes së OZHQ-ve nga perspektiva të ndryshme dhe do të forcojnë ndjenjën e tyre të pronësisë mbi OZHQ-të.

Duke qenë urë midis qeverive qendrore dhe atyre lokale, SHQL-të janë të pozicionuar mirë për të avokuar dhe mbështetur shtrirjen e procesit të pranimit në BE me OZHQ-të. Për shembull, ata mund të iniciojnë themelimin e një organi kombëtar të koordinimit të OZHQ-ve, i cili përfshin të gjitha palët e interesit, si qeverisjet kombëtare dhe nën-kombëtare, bizneset, shoqërinë civile etj. Për më tepër, SHQL-të mund të ndërtojnë kapacitetet e qeverisjeve snën-kombëtare përmes hartimit të programeve të trajnimit për

stafin komunal gjë që do t'i ndihmojë ata të kuptojnë rolin e tyre në procesin e arritjes së OZHQ-ve.

SHQL-të gjithashtu luajnë një rol të rëndësishëm në raportimin kombëtar mbi ecurinë e zbatimit të Agjendës 2030. Këto raporte duhet të jenë vullnetare dhe të udhëhequra nga shteti, duke përfshirë ministrinë dhe pjesëmarrësit e tjerë relevantë të nivelit të lartë. Prandaj, raportimi i OZHQ-ve kërkon koordinim të rëndësishëm midis ministrive dhe departamenteve të ndryshme, si dhe institucioneve kombëtare dhe nën-kombëtare. Në këtë kontekst, SHQL-të mund të lehtësojnë grumbullimin e të dhënave nga nivelet lokale, dhe procesin dhe përcjelljen e tyre tek organi raportues. Kjo mundëson që përpjekjet e qeverive lokale të përfshihen në raportet e përgjithshme kombëtare, ndërsa në të njëjtën kohë të clirojnë qeveritë lokale nga mbledhja dhe përpunimi i të dhënave.

Së fundi, SHQL-të duhet t'u shpjegojnë anëtarëve të tyre se edhe kryerja e thjeshtë e detyrave të përbashkëta të

nivelit nënkombëtar të qeverisë mund të kontribuojë në arritjen e OZHQ-ve. SHQL-të kanë shumë mjete në dispozicion për këtë qëllim: ato mund të organizojnë takime dhe ligjërata, të sigurojnë informata të rregullta për anëtarët e tyre në formë të buletinit apo mënyrave të ngjashme, të printojnë fletëpalosje dhe broshura që përmbajnë informata relevante, të organizojnë fushata të ndërgjegjësimit, etj.

NALAS

Si rrjet i shoqatave të autoriteteve lokale të Evropës Juglindore, NALAS bashkon 14 shoqata nga 12 vende, të cilat përfaqësojnë rreth 9,000 autoritete lokale, të zgjedhura drejtpërdrejt nga më shumë se 80 milionë banorë të rajonit. Kur mbron interesat e anëtarëve të saj, NALAS ka një bazë të fortë dhe mbështetje, jo vetëm në numrin e shoqatave anëtare apo qeverive lokale që mbulon por në përkushtimin e tyre të përgjithshëm për t'u bashkuar me

burimet dhe përpjekjet dhe për të sjellë ndryshime reale në rajon.

Nëpërmjet komunikimit të rregullt me qeveritë lokale dhe kombëtare, NALAS ka një pasqyrë të shkëlqyer të procesit të pranimit në BE në vendet candidate. Prandaj, është e pozicionuar mirë për të rritur ndërgjegjësimin lidhur me nevojën e përafrimit të procesit të pranimit në BE me OZHQ-të. Disa role të tjera të mundshme të NALAS u identifikuan në Konferencën Rajonale „Përfshirja Sociale dhe (Ri-) Integrimi në Agjendën 2030 dhe OZHQ-të“, që u mbajt në Slloveni në prill të vitit 2018. Përveç avokimit të përafrimit të procesit të integritimit në BE me OZHQ-të, u arrit në përfundim se NALAS mund të shpërndajë praktikën e mira të komunave që punojnë në OZHQ-të dhe të hartojë udhëzime praktike për zbatimin e OZHQ-ve në nivel lokal.

Duke bërë bashkë shoqata të qeverisjes lokale, zyrtarë komunalë të zgjedhur dhe ekspertë për tema të ndryshme, NALAS ka një mundësi unike për të krijuar njohuri me vlerë të madhe

për autoritetet lokale në EJL. NALAS nxit shkëmbimin e informacionit dhe përvojave midis anëtarëve të saj. Proceset e zbulimit, gjenerimit, kapitalizimit dhe shpërndarjes së njohurive përbëjnë Sistemin e Njohurive të NALAS. Pjesa kryesore e Sistemit të Njohurive është Qendra e Njohurive e NALAS për zhvillimin e qeverisjes lokale, e cila grumbullon njohuri të vlefshme që gjenden në analizat, krahasimet dhe praktikën më të mira ndërkuftare.

Shërbime të tjera kryesore të Qendrës së Informacionit të NALAS janë: Reagimi i Shpejtë, Programi i Vëzhgimit, vëzhgimi i kolegëve, dhe NALAS e-Academy. Përveç kësaj, Qendra e Njohurive e NALAS prodhon hulumtime krahasuese, instrumente, udhëzime, studime të rasteve dhe pozicione të politikave për çështje të ndryshme të qeverisjes vendore. Në këtë drejtim, Qendra e Njohurive NALAS mund të përdoret për shkëmbimin e praktikave të mira të komunave të angazhuara me OZHQ dhe ka një rol të rëndësishëm në proceset e ndërgjegjësimit.



6

**Informata të
mëtejshme**



1 Vegëza të ngjashme

Kombet e Bashkuara

Informata të përgjithshme:

<https://www.un.org/sustainabledevelopment/sustainable-development-goals/>

Platforma e njohurive:

<https://sustainabledevelopment.un.org/index.php?menu=1300>

Fushata e veprimt:

<https://sdgactioncampaign.org/>

UCLG

(Qytete dhe Qeveri Lokale të Bashkuara)

Çfarë duhet të dinë qeveritë. Botim nga UCLG:

https://www.uclg.org/sites/default/files/the_sdgs_what_localgov_need_to_know_0.pdf

Drejt lokalizimit të OZHQ-ve. Botim nga UCLG:

https://www.uclg.org/sites/default/files/towards_the_localization_of_the_sdgs.pdf

Bosnja dhe Hercegovina

ZAMISLI2030. Projekt largpamës në BeH:
<http://zamisli2030.ba/>

Shqipëri

<https://sustainabledevelopment.un.org/memberstates/albania>

Serbi

<https://sustainabledevelopment.un.org/memberstates/serbia>

Kosovë

<http://unkt.org/sustainable-development-goals-2/>

Maqedoni

<https://sustainabledevelopment.un.org/memberstates/macedonia>

Burime tjera

Si të fillohet me OZHQ në qytete. Botim nga SDSN dhe bashkëpunimi gjerman:
<http://unsdsn.org/wp-content/uploads/2016/07/9.1.8.-Cities-SDG-Guide.pdf>

Mbështetje lokale për sfidat globale. Botim nga VVSG (Asociacioni i Qyteteve dhe Komunave Flamande):

http://www.vvsg.be/Internationaal/Noord-Zuid/Documents/A4-TI_PublicatieDoelstellingen_0205_EN.pdf

2 Shtojca

Pasqyrë e mënyrës se si 6 OZHQ-të për përfshirje sociale ndërliohen me kapitujt e Ligjit të BE-së

17 OZHQ-të						
OZHQ 5 - synimet	5.1	5.2	5.3	5.5	5.a	5.c
Kapitujt përkatës të Legjislacionit të BE-së	23	23	23	23	11	23
					12	



17 OZHQ-të									
OZHQ 8 - synimet	8.1	8.2	8.3	8.5	8.6	8.7	8.8	8.9	8.b
Kapitujt përkatës të Legjislacionit të BE-së	20	27	19	3	26	19	19	20	19
		20	20	19		24			
				23					



17 OZHQ-të				
OZHQ 10 - synimet	10.2	10.3	10.4	10.7
Kapitujt përkatës të Legjislacionit të BE-së	19	23	19	24
	23			



17 OZHQ-të					
OZHQ 11 - synimet	11.2	11.6	11.7.	11.a	11.b
Kapitujt përkatës të Legjislacionit të BE-së	14	27	14	11	27
	21		27		



17 OZHQ-të									
OZHQ 16 - synimet	16.1	16.2	16.3	16.4	16.5	16.9	16.10	16.a	16.b
Kapitujt përkatës të Legjislacionit të BE-së	23	23	23	24	23	23	23	24	23



17 OZHQ-të		
OZHQ 17 - synimet	17.17	17.18
Kapitujt përkatës të Legjislacionit të BE-së	23	23



Mjeti i OKB-së për ndërveprim: Shpjegim i hollësishëm

AGJENDA 2030 DHE OZHQ-të

UDHËZIM PRAKTIK PËR PËRDORIMIN E MJETIT TË OKB-së PËR NDËRVEPRIM

1. Ndarja e pjesëmarrësve në grupe 6-anëtarëshe
2. Çdo grup koordinon 1 OZHQ (nga gjithsej 17) që do të adresohen gjatë punëtorisë, si dhe objektivin përkatës - të gjithë anëtarët e grupit votojnë dhe pajtohen me konsensus rreth një OBJEKTIVI dhe një SYNIMI brenda objektivit të zgjedhur dhe, pas shkrimit të synimit, karta vendoset në qendër të bazës.
3. ZGJEDHJA E KARTAVE MË VLERA – KARTAVE TË KALTRA - Trajneri shpjegon se çfarë janë kartat me vlera, lexon çdo kartë dhe e vendos atë në bazë.
 - a. Secili anëtar i grupit zgjedh një kartë dhe elaboron përzgjedhjen e tij / saj, dhe pastaj e vendos atë pranë kartës së synuar të vendosur tashmë në bazë
 - b. Pasi të jenë përzgjedhur, elaboruar dhe vendosur 6 karta, secili anëtar shkruan kartën e tij/saj të vlerës në formular
 - c. Çdo anëtar merr 3 shenja (tokenë) dhe i vendos ato në kartën „më të mirë“ (përveç kartës së tij / saj)
4. ZGJEDHJA E KARTAVE TË AKTIVITETEVE – KARTAVE TË KUQE – që mbështetin vlerën për të arritur OBJEKTIVIN. Trajneri ndjek procedurën e njëjtë si në rastin e kartave të kaltra.
 - a. Secili anëtar i grupit zgjedh një aktivitet, elaboron zgjedhjen që ka bërë dhe e fut aktivitetin në formular.
 - b. Shenjat (tokenët) vendosen duke ndjekur procedurën e njëjtë sikur tek kartat e kaltra.
5. Kjo procedurë përsëritet edhe për KARTAT E GJELBRA – ELEMENTET E SISTEMIT/MEKANIZMIT – të cilat nevojiten për arritjen e OBJEKTIVIT.
6. Pastaj përzgjedhen KARTAT E VERDHA - MUNDËSITË, PENGESAT, VËSHTIRËSITË, KUFIZIMET
 - a. Funkzioni i përzgjedhur i kartës duhet të theksohet në formular (mundësi, pengesë, vështirësi, kufizim)
 - b. Të gjithë anëtarët e grupit votojnë për kartat e përzgjedhura duke përdorur shenjat (tokenët) e tyre.
7. GRUPI PËRZGJEDHË 3 OBJEKTIVA SHITESË që e plotësojnë objektivin e përzgjedhur dhe i vendos pranë KARTAVE TË VERDHA
8. Pas kësaj, një përfaqësues i grupeve u paraqet të gjithë pjesëmarrësve punën e bërë nga grupi dhe si të arrihet OBJEKTIVI i zgjedhur sipas mendimit të grupit.

Marrëveshjet e grupeve të partneritetit në Bijelinë

Këto dokumente mund të shërbejnë si shabllone për formalizimin e grupeve partnere në komuna.

DEKLARATË E PËRBASHKËT PËR PARTNERITETIN LOKAL PËR ZHVILLIM

1. Ne jemi të vetëdijshëm që zhvillimi i komunës sonë duhet të udhëhiqet në mënyrë proaktive dhe me përgjegjësi, duke pasur parasysh parimin e zhvillimit të qëndrueshëm dhe përfshirjen sociale, që është baza e metodologjisë së planifikimit të MiPRO. Në përputhje me këto parime, ne kemi vendosur për një qasje të tillë për zhvillimin e komunës sonë, e cila do të kombinojë prosperitetin ekonomik me përfshirjen në rritje të kategorive shoqërore të ndjeshme të qytetarëve.
2. Ne jemi të bindur se problemet dhe sfidat e shumta të zhvillimit ekonomik dhe social, si dhe ruajtja e mjedisit, mund të zgjidhen më së miri përmes zbatimit të qasjes së integruar dhe përfshirjes nga publiku të të gjithë individëve, institucioneve, subjekteve ekonomike dhe organizatave, sektorit privat dhe joqeveritar, të cilët mund të kontribuojnë në zhvillimin e komunës tonë sipas kapacitetit dhe interesit të tyre.
3. Ne jemi të gatshëm, si qytetarë të [komunës] dhe si përfaqësues të sektorit ku punojmë, që të kontribuojmë në të gjitha aktivitetet që lidhen me Strategjinë për Zhvillimin e [komunës], si një instrument thelbësor për menaxhimin e zhvillimit të komunës. Për më tepër, ne jemi të gatshëm të kontribuojmë në zbatimin efikas dhe përditësimin e Strategjisë dhe planeve për zbatim, duke marrë pjesë në monitorimin sistematik të zbatimit dhe ofrimin e propozimeve konstruktive për të përshpejtuar zbatimin dhe përditësimin e Strategjisë dhe planeve në përputhje me rrethanat e ndryshuara.

4. Kontributi ynë fillestar do të pasqyrohet në pjesëmarrjen aktive në takimet e Partneritetit, të cilat do të organizohen dhe përgatiten nga [komuna] - Departamenti për Zhvillim Ekonomik Lokal dhe Integritet Evropian, të paktën dy herë në vit, dhe më shpesh nëse është e nevojshme. Për më tepër, jemi gjithashtu të gatshëm të japim mendimet, pozicionin, informacionin, komentet dhe sugjerimet tona në mes takimeve ose brenda funksionimit të grupeve sektoriale, sa herë që është e dobishme për zhvillimin e komunës sonë.
5. Gjatë punës së Partneritetit për zhvillimin e [komunës], ne do të respektojmë parimet e partneritetit të mirë: Zhvillimi i besimit dhe bashkëpunimit të ndërsjellë, përkushtimi ndaj interesit të përbashkët dhe të mirës publike, përhapjes së partneritetit dhe përfshirjes së partnerëve të tjerë të interesuar, dhe ndërmarrja e detyrimeve dhe përgjegjësisë të përbashkëta.
6. Kjo Deklaratë është e natyrës parimore dhe çështjet kyçe me interes për punën e suksesshme dhe efikase të Partneritetit për zhvillimin e [komunës]: kompetencat sipas metodologjisë së MiPRO-s, mënyra e thirrjes së parë dhe pjesës tjetër të takimeve / seanceve, mënyra e funksionimit, krijimi i anëtarëve të rinj, ndërprerja e anëtarësisë dhe çështjet e tjera rregullohen me një akt të veçantë.
7. Kjo Deklaratë, së bashku me listën e nënshkruar të pjesëmarrësve në mbledhjen e parë konstitutive të Partneritetit për zhvillimin e [komunës] është një akt konstituviv dhe pjesë përbërëse e procesverbalit.

RREGULLAT E FUNKSIONIMIT TË PARTNERITETIT PËR ZHVILLIMIN E [KOMUNËS]

Dispozitat themelore

Neni 1

1. Rregullat e Funkcionimit të partneritetit për zhvillimin e [komunës] (në tekstin e mëtejshëm: Rregullat e funksionimit) rregullojnë çështjet themelore të funksionimit të partneritetit për zhvillimin e [komunës] (në tekstin e mëtejshëm: Partneriteti), si një mekanizëm kyç për përfshirjen e komunitetit dhe menaxhimin e zhvillimit lokal, që synon sigurimin e ndikimit të qytetarëve në vendimmarrje në lidhje me zhvillimin ekonomik dhe social dhe mbrojtjen e mjedisit në [komunë].
2. Rregullat e Funkcionimit përcaktojnë si në vijim:
 - ▶ Parimet themelore të Partneritetit,
 - ▶ Kompetencat e Partneritetit (rolet dhe përgjegjësitë),
 - ▶ Seanca e parë e Partneritetit, Kohëzgjatja, ndërprerja e anëtarësisë dhe pranimi i anëtarëve të rinj,
 - ▶ Përcaktimi i seancës dhe mënyrës së funksionimit të Partneritetit,
 - ▶ Vendimmarrja në seancat e Partneritetit (plenary dhe sektorial),
 - ▶ Procesverbalet nga seanca e Partneritetit,
 - ▶ Roli i koordinatorit të Partneritetit
 - ▶ Dhe çështje të tjera me interes për funksionimin e Partneritetit.

Neni 2

Dispozitat nga këto Rregulla të Funkcionimit janë të detyrueshme për të gjithë anëtarët e Partneritetit, gjatë kohëzgjatjes së partneritetit, si dhe për personat e tjerë të ftuar për të marrë pjesë në punën në seancat e Partneritetit.

1. Parimet themelore të Partneritetit

Neni 3

Partneriteti do të mbajë parimet e mëposhtme gjatë funksionimit të tij:

- ▶ Zhvillimi i besimit dhe bashkëpunimit reciprok,
- ▶ Njohja dhe përkushtimi ndaj interesave të përbashkëta dhe të mirës publike,
- ▶ Zgjerimi i vazhdueshëm i partneritetit duke inkurajuar subjektet relevante për proceset e zhvillimit lokal që të përfshihen dhe të kontribuojnë në punën e Partneritetit,
- ▶ Partneriteti do të krijohet si një mjet i rregullt komunikimi ndërmjet administratës dhe qytetarëve lidhur me proceset zhvillimore dhe duhet të kuptohet si një partneritet afatgjatë i cili nuk do të përfundojë me përfundimin e procesit të planifikimit strategjik,
- ▶ Partneriteti do të krijojë marrëdhënie institucionale me organet dhe institucionet që ndikojnë në proceset zhvillimore (tregu i punës, zhvillimi i burimeve njerëzore - institucionet arsimore, etj.),
- ▶ Ndërmarrja e obligimeve dhe përgjegjësi të përbashkëta dhe të dakorduara,
- ▶ Partneriteti formalizohet nëpërmjet Grupit të Partneritetit (GP) i cili përbëhet nga nëngrupet e partneritetit sektorial (NGPS).

2. Kompetencat e Partneritetit (rolet dhe përgjegjësitë)

Neni 4

Kompetenca (roli dhe përgjegjësia) e Grupit të Partneritetit do të jetë rishikimi dhe harmonizimi i elementeve kyçe të Strategjisë dhe roli gjatë zbatimit, veçanërisht:

- ▶ Shqyrtimi i orientimit strategjik për periudhën [...],
- ▶ Shqyrtimi i planeve sektoriale dhe planeve operacionale trevjeçare,
- ▶ Sigurimi i rekomandimeve dhe sugjerimeve për përmirësimin e këtyre planeve dhe miratimin e tyre
- ▶ Asistencë konsultative në zbatimin, mbikëqyrjen dhe përditësimin e strategjisë së zhvillimit
- ▶ Çështje të tjera të iniciuara nga Partneriteti dhe të deleguara për shqyrtim me qëllim të mbështetjes për proceset e zhvillimit.

92

3. Seanca e parë e Grupit të Partneritetit, përbërja, ndërprerja e anëtarësisë dhe pranimi i anëtarëve të rinj

Neni 5

1. Seanca e parë e mbledhjes së parë të Partneritetit do të caktohet nga Kryetari i [komunës], me mbështetjen operacionale të Departamentit për Zhvillim Ekonomik Lokal dhe Integrim Evropian.
2. Letra e ftesës për akterët e përcaktuar, përveç vendit dhe datës së mbajtjes së seancës së parë të Partneritetit, gjithashtu shpjegon rolin e Partneritetit në procesin e planifikimit strategjik, procesin e realizimit të strategjisë, vlerësimin dhe përditësimin e tyre, si dhe mundësinë e hapur për të diskutuar çështje të tjera të rëndësishme që lidhen me proceset zhvillimore të komunës.
3. Anëtarët e Grupit të Partneritetit (GP) emërohen nga Kryetari i Komunës dhe GP gjithashtu do të përbëhen nga anëtarë nga nëngrupet e partneritetit sektorial (NGPS) të emëruar nga Kryetari i Komunës.

Neni 6

1. Partneriteti përbëhet nga 50 anëtarë dhe përveç përfaqësuesve nga Kuvendi i [komunës] dhe nga qeveria ekzekutive, ka edhe përfaqësues nga sektori i biznesit, komunitetet, OJQ-të, gratë, kategoritë e marginalizuara (refugjatët, personat e zhvendosur, të kthyerit, pakicat kombëtare, etj.), si dhe akterë të tjerë të rëndësishëm të cilët i janë përgjigjur ftesës për Partneritet.
2. Përbërja e Grupit të Partneritetit mban përfaqësim adekuat të sektorëve të ndryshëm ekonomikë, sipërmarrësve, përfaqësuesve proaktiv të shoqërisë civile (shoqatat civile dhe profesionale), komuniteteve urbane dhe rurale etj.
3. Përfaqësuesit e sektorit të biznesit / privat dhe OJQ-të marrin pjesë në përbërjen e Grupit të Partneritetit me së paku 50% të anëtarëve.
4. Anëtarësia ndoshta përkufizohet me emrin e institucionit / organizatës, entitetit ekonomik / OJQ / Komunitetit ose emrit të personit konkret.
5. Anëtarësia në grupin e Partneritetit duhet të përbëhet nga përfaqësues të të gjitha opsioneve politike, duke përfshirë anëtarët që nuk i përkasin ndonjë opsioni politik.

Neni 7

1. Grupi i Partneritetit themelohet për periudhën e vlefshmërisë së Strategjisë.
2. Anëtarësimi në grupin e Partneritetit do të përfundojë me skadimin e afatit nga paragrafi i mëparshëm, duke mos marrë pjesë në punën e grupit të Partneritetit dhe me deklaratën e shpjegimit me shkrim për dalje nga grupi i Partneritetit nga vet anëtari.
3. Grupi i Partneritetit mund të zgjatet me propozimin e vetë Grupit, [Komunës] ose në bazë të interesit personal të akterëve të rinj, për të cilët do të vendosë Partneriteti.

4. Mënyra e funksionimit të grupit të Partneritetit

Neni 8

1. Seanca e parë e mbledhjes së parë, në përputhje me nenin 5 të këtyre Rregullave të Funksionimit, do të jetë mbledhje konstitutive.
2. Seanca e parë e çdo mbledhje tjetër të Grupit të Partneritetit thirret nga Kryesuesi i Grupit të Partneritetit, mandati i të cilit është në skadim.
3. Partneriteti do të bëjë gjërat e mëposhtme në seancën e tij konstituive:
 - ▶ Do të miratojë një deklaratë të përbashkët për Partneritetin,
 - ▶ Do të zgjedhë kryesuesin e grupit të Partneritetit dhe zëvendëskryesuesin,
 - ▶ Do të miratojë Rregullat e Funksionimit të Partneritetit, dhe
 - ▶ Do të miratojë një Plan Veprimi.
4. Në raste të jashtëzakonshme, Rregullat e Funksionimit mund të miratohen në seancën vijuese të Partneritetit.

94

Neni 9

Kryesuesi, dhe në rast të mungesës së tij/saj, zëvendëskryesuesi/ja, do të përfaqësojë Partneritetin, do të nënshkruajë aktet e grupit të Partneritetit dhe do të sigurohet që funksionimi i Grupit të Partneritetit të bëhet në përputhje me Rregullat e Funksionimit.

Neni 10

1. Kryesuesi i grupit të Partneritetit (në mungesë të tij, zëvendëskryesuesi) përgatit dhe thërrret seancën e radhës të Grupit të Partneritetit, me ndihmën operative të organit Koordinues për monitorimin e zbatimit.
2. Seanca thirret në përputhje me Planin e Veprimit, me propozimin e organit Koordinues për monitorimin e zbatimit të Strategjisë (kur hartimi i Strategjisë është në vazhdim), me Kryetarin e Komunës, me Kryesuesin ose me iniciativën e të paktën 1 / 3 të anëtarëve të Grupit të Partneritetit.

3. Iniciativa për një takim të grupit të Partneritetit mund të vijë gjithashtu nga grupi i qytetarëve, operatorëve ekonomikë ose individëve që nuk janë anëtarë të grupit të Partneritetit, nëpërmjet anëtarëve aktualë të grupit të Partneritetit ose përmes ekipit Koordinues për monitorimin e zbatimit të Strategjisë, me shpjegimin e interesit që Grupi i Partneritetit duhet të marrë në konsideratë dhe të marrë qëndrim për çështje të caktuara.

Neni 11

Grupi i Partneritetit mblidhet:

- ▶ Të paktën dy herë në fazën e planifikimit të zhvillimit strategjik,
- ▶ Së paku dy herë në vit në fazën e zbatimit të Strategjisë (përqëndrohet në shqyrtimin e Raportit Vjetor mbi zbatimin dhe përditësimin e planit trevjeçar për zbatimin),
- ▶ Të paktën dy herë në fazën e përditësimit të Strategjisë.

Neni 12

1. Sipas rregullit, Grupi i Partneritetit do të punojë në seanca plenare.
2. Me qëllim të punës më efektive në tema specifike, pa marrë parasysh nëse është deklaruar në ftesë ose është vendosur në seancën plenare, Grupi i Partneritetit mund të punojë i ndarë në nëngrupe sektoriale:
 - ▶ Këshilli ekonomik,
 - ▶ Nëngrupi i partneritetit sektorial për zhvillim social (NGS),
 - ▶ Nëngrupi i partneritetit sektorial (NGPS) për mbrojtjen e mjedisit.
3. Anëtarët e nëngrupeve të partneritetit sektorial (NGPS) emërohen nga kryetari i komunës dhe emërohen edhe anëtarë të grupit plenar të partneritetit (neni 5 i Rregullave të Funkcionimit).
4. Nëngrupet e partneritetit sektorial do të zgjedhin koordinatorët e tyre, të cilët do të jenë kompetent për kryerjen e punës në përputhje me kompetencat e nëngrupit të partneritetit sektorial dhe në përputhje me dispozitat e këtyre Rregullave të Funkcionimit.

Neni 13

Përveç seancave, kur është e nevojshme, Grupi i Partneritetit mund të përdorë modalitete të tjera operacionale (punëtori, tryeza të rrumbullakëta, diskutime në panele, forume, etj.).

Neni 14

1. Ftesa për takim përbëhet nga: Numri i seancës, vendi, data dhe koha e mbajtjes së mbledhjes, agjenda e propozuar, shënimi nëse është seancë plenare apo sektoriale, emrat dhe mbiemrat e profesionistëve të ftuar të cilët nuk janë anëtarë të grupit të Partneritetit, si dhe njoftimi për të ftuarit që ata duhet të konfirmojnë praninë e tyre (ose të njoftojnë nëse nuk mund të vijnë).
2. Agjenda përcaktohet nga Kryesuesi në bashkëpunim me ekipin Koordinues për monitorimin e zbatimit të Strategjisë.
3. Ftesa duhet të adresohet me e-mail ose në ndonjë mënyrë tjetër të përshtatshme, të paktën 7 ditë para mbajtjes së mbledhjes.
4. Një kopje e Procesverbalit nga seanca e mëparshme dërgohet së bashku me ftesën dhe një material përmbledhës për çështjet që do të diskutohen.

Neni 15

1. Partneriteti mund të punojë nëse gjysma e anëtarëve kanë konfirmuar praninë e tyre, ndërsa së paku 50% të sektorit privat dhe civil.
2. Në rast të mospërbushjes së kushtit nga paragrafi i mëparshëm, takimi do të shtyhet deri në orarin e ri.
3. Në rast se një anëtar i grupit të Partneritetit nuk mund të marrë pjesë, ata mund t'i japin autorizimin një personi tjetër, i cili është përfaqësues adekuat i institucionit / organizatës / shoqërisë të cilës i takon anëtari i grupit të partneritetit.

1. Grupi i Partneritetit kryen veprimtarinë e tij në ambientet e kushteve adekuate të siguruar nga administrata komunale.
2. Mbështetja operationale për punën e Grupit të Partneritetit sigurohet nga Departamenti për Zhvillim Ekonomik Lokal dhe Integrim European, i cili kryen këto aktivitete:
 - ▶ Përgatitjen, në bashkëpunim me Kryesuesin e Seances së Grupit të Partneritetit (dhe forma të tjera të punës, sipas nenit 11 dhe 12 të këtyre Rregullave të Funkionimit), mbanë procesverbalin nga seancat dhe regjistrimet e pjesëmarrjes së anëtarëve të Grupi i partneritetit, duke pasur parasysh strukturën gjinore,
 - ▶ U ofron anëtarëve të Grupit të Partneritetit një kopje të procesverbalit nga seanca, brenda 7 ditëve nga mbajtja e seancës ose mënyra të tjera të punës,
 - ▶ Harton një raport mbi realizimin e përfundimeve nga seanca e mëparshme e Grupit të Partneritetit,
 - ▶ Nëse është e nevojshme dhe në përputhje me përfundimin e grupit të Partneritetit, organizon tryeza të rumbullakëta, punëtori, forume etj., lidhur me çështjet e deleguara nga anëtarët e grupit të Partneritetit,
 - ▶ Kryen marrjen dhe shkëmbimin e informacionit përkatës midis seancave të Grupit të Partneritetit, duke përfshirë përgatitjen e informacionit për publikim në faqen zyrtare të administratës komunale dhe mediat tjera informative,
 - ▶ Mbledh / dokumenton të dhëna për punën e Grupit të Partneritetit dhe kontributin e Partneritetit në zhvillimin ekonomik dhe social lokal dhe mbrojtjen e mjedisit (dokumentacion fotografik, artikuj nga shtypi, shënime mbi kontaktet e vendosura, etj.).

Neni 17

Kryesuesi i grupit të Partneritetit në fillim të çdo seance:

- ▶ Përcakton numrin e anëtarëve të pranishëm, numrin e anëtarëve të pranishëm si zëvendësues të autorizuar me shkrim, numrin e personave të ftuar, duke marrë shënim për strukturën gjinore,
- ▶ Propozon Agjendën për seancën, dhe
- ▶ Hap punën pas miratimit të Agjendës me shënim nëse është seancë plenare ose seancë sektoriale.

5. Vendimmarrja në seancat e Grupit të Partneritetit (plenar dhe sektorial)

Neni 18

1. Grupi i Partneritetit punon dhe vendos nëse kushti nga neni 14 i këtyre Rregullave të Funksionimit është plotësuar.
2. Në rast të mungesës së kuorumit, Grupi i Partneritetit mund të diskutojë çështje të caktuara, por vetëm si konsultime në formë të shkëmbimit të mendimit, pa marrjen e vendimeve.
3. Para se të vazhdojë me Agjendën, verifikimi i transkriptit të procesverbalit të seancës së mëparshme, në përputhje me nenin 15, paragrafi 2, u dërgohet anëtarëve të grupit të Partneritetit, brenda 7 ditëve nga dita e mbajtjes së seancës së mëparshme.
4. Agjenda e propozuar miratohet, me mundësi për ta ndryshuar atë në kohën e ndryshimit të saj.

Neni 19

1. Shqyrtimi i çështjeve të caktuara bëhet sipas rendit të agjendës së miratuar.
2. Sipas rregullave, paraqiten shënime hyrëse dhe sqarime në lidhje me çështjet brenda agjendës.
3. Me qëllim të punës më efikase, diskutimet mund të kufizohen me kohë.
4. Grupi i Partneritetit mund të kërkojë që disa nga çështjet të shqyrtohen më parë ose më vonë nga një organ tjetër punues, për promovimin e zhvillimit.
5. Partneriteti është i obliguar që të diskutojë dhe të marrë qëndrim në lidhje me çështjet e deleguara nga një organ tjetër punues në funksion të zhvillimit lokal.

Neni 20

1. Grupi i Partneritetit vendos për formën e rekomandimeve, përfundimeve, iniciativave, propozimeve dhe opinioneve.
2. Votimi është public (i hapur).
3. Vendimi konsiderohet i miratuar nëse më shumë se gjysma e pjesëmarrësve të pranishëm votuan për propozimin, ndërsa shumica përfshin përfaqësuesit e të gjithë partnerëve socialë dhe ekonomikë.

6. Procesverbali mbi punën e grupit të Partneritetit

Neni 21

1. Procesverbali i çdo seance të mbajtur të Grupit të Partneritetit përmban:
 - ▶ Numrin rendor të seancës, datën, kohën dhe vendin, kohën e fillimit dhe mbarimit të seancës,
 - ▶ Regjistrimin e pjesëmarrjes së anëtarëve të grupit të Partneritetit dhe pjesëmarrësve të tjerë që marrin pjesë në punë, duke pasur parasysh strukturën gjinore,

- ▶ Agjendën e miratuar,
 - ▶ Informacione për verifikimin e procesverbalit nga seanca e mëparshme dhe realizimin e përfundimeve, rekomandimeve etj.
 - ▶ Përmbledhjen e diskutimit të çdo pike të agjendës, me emrat e folësve hyrës dhe pjesëmarrësve në diskutim,
 - ▶ Rezultatet e votimit dhe llojit të vendimit të miratuar (rekomandim, përfundim, iniciativë, propozim, opinion) dhe se kujt i dërgohen për veprim të mëtejshëm.
2. Kryesuesi mund të vendosë që në procesverbal të përfshijë fakte të tjera, që konsiderohen të rëndësishme për punën dhe pozicionin e grupit të Partneritetit.
 3. Kryesuesi mund të vendosë që të audio regjistrojë tërë seancën ose ndonjë pjesë të seancës, dhe duhet të informojë grupin e Partneritetit për këtë.

Dispozitat përfundimtare

Neni 22

1. Këto Rregulla të Funkzionimit do të hyjnë në fuqi në datën e miratimit të tyre nga Grupi i Partneritetit dhe do të publikohen në Gazetën Zyrtare të [komunës] dhe faqen zyrtare të [komunës].
2. Ndryshimet në Rregullat e Funkzionimit do të miratohen në një mënyrë dhe sipas një procedure të përdorur për miratimin e Rregullave të Funkzionimit.

**VENDIM MBI THEMELIMIN
E KËSHILLIT EKONOMIK
TË [KOMUNËS]**

Neni 1

Këshilli Ekonomik i [Komunës] (në tekstin e mëtutjeshëm referuar si Këshilli Ekonomik) si organ i përhershëm i punës me Kryetarin e [Komunës] është duke u themeluar me qëllim të sigurimit të pjesëmarrjes dhe ndikimit të përfaqësuesve të aktiviteteve ekonomike dhe aktiviteteve të tjera për menaxhim me zhvillimin ekonomik lokal dhe promovimin e mjedisit të biznesit në [komunë].

Këshilli Ekonomik do të jetë një organ këshillues, i cili do të ofrojë mendime dhe ndërmerrë iniciativa lidhur me çështjet që lidhen me ekonominë dhe masat për nxitjen e zhvillimit ekonomik lokal.

Këshilli Ekonomik do të ketë funksionin e komunikimit dhe promovimit të dialogut publiko-privat, dhe nëpërmjet bashkëpunimit të drejtpërdrejtë në mes të administratës së komunës dhe përfaqësuesve të aktiviteteve ekonomike dhe aktiviteteve tjera të ngjashme.

Neni 2

Këshilli Ekonomik do të përbëhet nga përfaqësues të kompanive ekonomike me sukses dhe me ndikim në fushën e [komunës], duke përfshirë kompanitë publike, përfaqësuesit e odës rajonale të tregtisë, përfaqësuesit e operatorëve ekonomik të pavarur, përfaqësuesit e shoqatave, institucionet arsimore të dedikuara për arsimimin e profesionistëve në fushën e ekonomisë dhe fushat që lidhen me të, përfaqësuesit nga agjencia e punësimit, si dhe përfaqësuesit e administratës komunale të përfshira në fushën e ekonomisë.

Të paktën gjysma e anëtarëve të Këshillit Ekonomik do të jenë përfaqësues të kompanive nga industritë më të rëndësishme në rajonin e komunës, prej të cilave, së paku një e treta nga sektori i prodhimit.

Anëtarët e Këshillit Ekonomik do të jenë persona në pozita përkatëse brenda kompanive, organizatave dhe organeve nga vijnë.

Këshilli Ekonomik mund të ketë deri në 20 anëtarë.

Këshilli Ekonomik emërohet nga Kryetari i Komunës, me një vendim të veçantë në përputhje me këtë

Neni 3

Këshilli Ekonomik është organ pune me mandatin e mëposhtëm:

- ▶ Monitorimi i çështjeve në fushën e ekonomisë në komunë dhe propozimi i masave dhe rekomandimeve përkatëse për promovimin e zhvillimit ekonomik.
- ▶ Sigurimi i mendimit, rekomandimit dhe iniciativave lidhur me përgatitjen, njoftimin dhe rishikimin e planit strategjik për zhvillimin e komunës dhe planin e zbatimit
- ▶ Shqyrtimi i çështjeve të rëndësishme të zhvillimit dhe çështjeve që lidhen me promovimin e mjedisit të biznesit dhe konkurrencës,
- ▶ Fillimi i iniciativave (propozime, masa, rekomandime) për përmirësimin e mjedisit të përgjithshëm të biznesit në [komunë],
- ▶ Sigurimi i mbështetjes për këshillimin e Kryetarit për vendimmarrje në lidhje me zhvillimin ekonomik të komunës, programet dhe projektet zhvillimore,
- ▶ Përcjellja e të gjitha çështjeve me interes për ekonominë dhe zhvillimin ekonomik lokal dhe propozimi i masave dhe aktiviteteve përkatëse për organet kompetente lokale,
- ▶ Propozimi i masave për promovimin e procedurave administrative lidhur me zhvillimin ekonomik lokal,
- ▶ Shqyrtimi dhe dhënia e mendimeve lidhur me aktet e propozuara që rregullojnë taksat dhe tarifat vendore,
- ▶ Bashkëpunimi me organe të njëjta ose të ngjashme në qytete dhe komuna të tjera, subjekte ekonomike, institucione, organe, organizata dhe shoqatat e tyre, shoqatat e prodhuesve, përpunuesve dhe organizatave të tjera të interesuara në çështjet relevante për fushën e tyre,
- ▶ Monitorimi dhe pjesëmarrja në aktivitetet për promovimin e [komunës] dhe potencialit të saj ekonomik,
- ▶ Shqyrtimi i çështjeve të tjera që lidhen me zhvillimin ekonomik lokal në [komunë].

Neni 4

Këshilli Ekonomik do të ketë kryesues dhe zëvendëskryesues, i cili zgjidhet nga anëtarët e Këshillit Ekonomik, me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve.

Këshilli Ekonomik do të kryejë punën e tij në seanca, nëse është shumica e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të pranishëm në seancë.

Seancat e Këshillit Ekonomik do të mbahen të paktën një herë në tre muaj.

Gjatë punës së tij, Këshilli Ekonomik vendos me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm për çështjet në fushën e punës së tij, nëse nuk përcaktohet ndryshe me këtë vendim të rregullave të funksionimit të Këshillit Ekonomik.

Këshilli Ekonomik do të miratojë konkluzione me të cilat do të përcaktojë qëndrimin, mendimet, propozimet ose rekomandimet e tij ose do të paraqesë iniciativa lidhur me çështje të caktuara që ndodhin gjatë punës së tyre, në përputhje me këtë vendim.

Këshilli Ekonomik vendos me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve për Rregullat e Funksionimit, gjë që rregullon në detaje çështjet e organizimeve të brendshme, mbledhjen dhe mbajtjen e seancave, edukimin e trupave punues të ekspertëve, mbajtjen e shënimeve dhe akteve dhe çështje të tjera të rëndësishme për zbatimin efikas të funksioneve të tij. Aktet e Këshillit Ekonomik verifikohen me vulën e Kryetarit të Komunës.

Njësitë organizative të administratës komunale janë të detyruara të shqyrtojnë përfundimet, rekomandimet dhe iniciativat e Këshillit Ekonomik, të informojnë Këshillin për mendimet e tyre brenda një periudhe jo më të gjatë se 15 ditë dhe me kërkesë të Këshillit Ekonomik të paraqesin të dhëna dhe informacionin e rëndësishëm për punën e tyre.

Puna profesionale, administrative dhe teknike për qëllimet e Këshillit Ekonomik kryhet nga Zyra e Kryetarit të Komunës - Departamenti për Zhvillim Ekonomik Lokal dhe Integrim Evropian.

Neni 5

Funksionimi i Këshillit Ekonomik mund të përfshijë gjithashtu përfaqësues nga shoqatat ekonomike dhe të tjera, përfaqësues të organeve, organizatave, institucioneve dhe subjekteve ekonomike, kur Këshilli Ekonomik është duke shqyrtuar çështjet që janë në kompetencën, fushën e veprimtarisë ose të funksionimit të tyre.

Këshilli Ekonomik mund të organizojë konferenca, tryeza të rrumbullakëta dhe forma të tjera të tubimeve profesionale për të diskutuar promovimin e zhvillimit ekonomik lokal.

Neni 6

Gjatë kryerjes së veprimtarive në fushën e veprimt, Këshilli Ekonomik mund të themelojë organe të posaçme të punës për veprimtari ekonomike ose kritere të tjera, të cilat do të kenë rol konsultativ në analizimin e disa çështjeve ose në përgatitjen e mendimeve dhe rekomandimeve për qëllime të promovimit të aktiviteteve të biznesit.

Neni 7

Vendimet, rregullat e funksionimit dhe aktet e tjera të miratuara nga Këshilli i Përhershëm Ekonomik deri më tani do të mbeten në fuqi si akte të Këshillit Ekonomik.

Kryesuesi dhe zëvendëskryesuesi i cili zgjodhi Këshillin e Përhershëm Ekonomik do të mbesin në funksion deri në miratimin e vendimit tjetër të Këshillit Ekonomik.

Neni 8

Vendimi për emërimin e Këshillit Ekonomik miratohet nga Kryetari brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

Neni 9

Këshilli Ekonomik do të harmonizojë Rregullat e Funksionimit me dispozitat e këtij vendimi brenda tre muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

Neni 10

Ky vendim hyn në fuqi ditën e tetë nga data e publikimit në Gazetën Zyrtare të [komunës].

VENDIM MBI THEMELIMIN E GRUPIT TË PARTNERITETIT „PARTNERITETI PËR ZHVILLIMIN E KOMUNËS“ - ZHVILLIMI SOCIAL I KOMUNËS

I

Përfshirja aktive e qytetarëve në proceset e menaxhimit dhe vendimmarrjes, në përputhje me një metodologji të standardizuar për menaxhimin e integruar të zhvillimit lokal në [vend], përbën angazhim strategjik të [komunës]. Si pjesë e këtyre aktiviteteve, [komuna] do të krijojë një grup „Partneriteti për zhvillimin e komunës“, si një mekanizëm kyç për përfshirjen e komunitetit dhe menaxhimin e zhvillimit lokal, që synon sigurimin e ndikimit nga qytetarët në vendimmarrje në lidhje me zhvillimin ekonomik dhe social dhe mbrojtjen e mjedisit.

„Partneriteti për zhvillimin e [komunës]“ do të jetë organi këshillëdhënës i komunës, i themeluar nga kryetari i komunës dhe do të jetë një mekanizëm thelbësor për përfshirjen e komunitetit dhe menaxhimin e zhvillimit lokal, domethënë instrument për komunikimin e qytetarëve me administratën komunale.

Grupi i Partneritetit Sektorial (GPS) për zhvillim social i cili do të përbëhet nga përfaqësues të institucioneve arsimore, shëndetësore dhe sociale (CSR), institucionet e kulturës, shoqatat civile aktive në këtë fushë, sidomos shoqatat e fokusuara në grupet e cenueshme dhe shërbimet sociale, organi koordinues për monitorimin e zbatimit të Strategjisë për Zhvillim, Mediat dhe Departamenti për Zhvillim Ekonomik Lokal dhe Integrim Evropian, duhet të fokusohet në:

- ▶ Monitorimin e lëvizjes sociale dhe ndryshimeve në komunitetin lokal me qëllim të promovimit të zhvillimit dhe plotësimit të nevojave të qytetarëve në këtë fushë dhe propozimi i aktiviteteve për vetëqeverisjen lokale dhe përmirësimi i procedurave,
- ▶ Monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të projekteve dhe strategjive për zhvillimin social lokal;
- ▶ Rishikimin e Strategjisë për zhvillim dhe planet për zbatimin e saj;
- ▶ Mbështetje konsultative për kryetarin e komunës në vendimmarrjen lidhur me zhvillimin shoqëror dhe programet zhvillimore, duke përfshirë programin për përfshirjen sociale të grupeve të cenuara;

- ▶ Bashkëpunimin me Departamentin për Zhvillim Ekonomik Lokal dhe Integrim Evropian dhe Organin Koordinues për monitorimin e zbatimit të Strategjisë së Zhvillimit.

II

Personat e mëposhtëm janë emëruar në
„Partneritetin për zhvillimin e [komunës]“
- sektori social:

1. [Lista e emrave dhe organizatave]

2.

III

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit të tij dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare të [komunës].

VENDIM MBI THEMELIMIN E GRUPIT TË PARTNERITETIT „PARTNERITETI PËR ZHVILLIMIN E KOMUNËS“ - MBROJTJA E MJEDISIT

I

Përfshirja aktive e qytetarëve në proceset e menaxhimit dhe vendimmarrjes, në përputhje me një metodologji të standardizuar për menaxhimin e integruar të zhvillimit lokal në [vend], përbën angazhim strategjik të [komunës]. Si pjesë e këtyre aktiviteteve, [komuna] do të krijojë një grup „Partneriteti për zhvillimin e komunës“, si një mekanizëm kyç për përfshirjen e komunitetit dhe menaxhimin e zhvillimit lokal, që synon sigurimin e ndikimit nga qytetarët në vendimmarrje në lidhje me zhvillimin ekonomik dhe social dhe mbrojtjen e mjedisit.

„Partneriteti për zhvillimin e [komunës]“ do të jetë organi këshillëdhënës i komunës, i themeluar nga kryetari i komunës dhe do të jetë një mekanizëm thelbësor për përfshirjen e komunitetit dhe menaxhimin e zhvillimit lokal, domethënë instrument për komunikimin e qytetarëve me administratën komunale.

Grupi i partneritetit sektorial për mbrojtjen e mjedisit, i përbërë nga anëtarë të emëruar të institucioneve relevante për mbrojtjen e mjedisit, përfaqësues nga trupi koordinues, përfaqësues nga shoqatat civile aktive në këtë fushë, mediat dhe departamenti për zhvillim ekonomik lokal dhe integrimi evropian, duhet të fokusohet në:

- ▶ Monitorimin e të gjitha çështjeve me interes për mbrojtjen e mjedisit, dhe propozimin e aktiviteteve për vetëqeverisjen lokale dhe përmirësimin e procedurave;
- ▶ Monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të projekteve dhe strategjive relevante për mbrojtjen e mjedisit;
- ▶ Rishikimin e Strategjisë për zhvillim dhe planet për zbatimin e saj;
- ▶ Mbështetje konsultative për Kryetarin e Komunës për të vendosur mbi mbrojtjen e mjedisit dhe programet e zhvillimit;

- ▶ Bashkëpunimin me Departamentin për Zhvillim Ekonomik Lokal dhe Integrim Evropian dhe Organin Koordinues për monitorimin e zbatimit të Strategjisë së Zhvillimit.

II

Personat e mëposhtëm janë emëruar në „Partneritetin për zhvillimin e [komunës]“:

1. [Lista e emrave dhe organizatave]
- 2.

III

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit të tij dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare të [komunës].

Publikuar nga

Deutsche Gesellschaft für Internationale
Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

Zyrat e regjistruarae

Bonn dhe Eschborn, Gjermani

Projekti Rajonal për të Drejtat Sociale të
Grupeve të Cenuara (SoRi)
Antonie Grubishikj Nr.5
1000, Shkup
Maqedoni

T +389 2 3103 570
E Michael.Samec@giz.de
I www.giz.de

Dizajni

Koma, Shkup

GIZ-i është përgjegjës për përmbajtjen e këtij
publikimi

Në emër të
BMZ